

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 165, Korrik 2017

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

2 SAKRIFICA DHE ELJA PËR SHKOLLIN

45 VJETORI I TË PARAVE "DEFTESAVE TE LIRIMIT" NË SHKOLLEN 8 VJEÇARE, PLAN-GJURAJ

Me kënaqësi kam përcjellë shumë shkrime në gazetën Dukagjini, për arsimin në këtë zonë. Si unë, besoj se janë dhe shumë të tjerë që i lexojnë me inters këto shkrime. Është një nisëm e rëndësishme e Shoqatës Dukagjini që duhet përshëndetur dhe mbështetur me sa mundësi janë. Ndoshta duhet konsideruar një histori me shumë autorë dhe shumë vlera, të gjithë ata që kanë shkruar dhe hulumtuar në këtë drejtim. Nderim, respekt e mirënjohje për gjithë shkruesit e kësaj teme e veçmas për mësuesit tanë.

3 MËSUES DY MUAJ NË FSHATIN MGULLE PULI

"KUJDESU PËR KUJTIMET E TUA, SEPSE NUK MUND TI JETOSH PËRSËRI" - BOB DYLAN, NOBELIST

Në jetën e njeriut, dy muaj nuk zënë ndonjë vend të rëndësishëm. Por, për mua, dy muaj të fillimit të punës si mësues në fshatin Mguullë, kanë shumë vlerë. Do të përpiqem që t'j pasqyroj disa kujtime, për këtë fshat, për shkollën fillore, për nxënësit, si dhe në veçanti për familjen e Tomë Ndokës, ku unë i jetova këta dy muaj. Mjeshtri i letra shqipe, profesori i nderuar Nasho Jorgaqi, duke folur për kujtimet, thotë: "Çdo njeri, në jetën e tij, ka kujtime të ndryshme të cilat herë të të ledhatojnë, ...

6 Si u ndërtua Kisha Françeskane në Shkodër me dekret të sulltan Hamidit

(Nga ditari i PJETER LOGORECIT)

Ballabane quhet ajo zonë e qytetit të Shkodrës, (në mes Serreqit, varrezave të Rrmajit, Gjuhadolit dhe Dugajve të reja), prej ku dolën personalitete shqiptare të kulturës, të rangut kombëtar. Personalisht, isha me fat që linda dhe kalova fëmijërinë në këtë lagje, në një kohë (brez) që pat mundësinë e fundit të kishte kontakte me këto korifej të atdhetarisë e kulturës...

7 THESARE TURISTIKE TË DUKAGJINIT

Blini i Gurit të Lekës, ndodhet në vendpjekjen e Lumit të Shalës me Liqenin e Kommanit, në prehrin e Komlemit, karshi Mollës së Shoshit me plot histori, histori e varrosur aty e cila lidhet me princin tonë Lekë Dukagjini. Prof. Ahmet Osja, i cili ka jetuar e punuar për vite me rradhë në këtë zonë thotë që Lekë Dukagjini vitet e fundit të jetës i kaloi në këtë vend, përballë i mbrojtur nga humnerat shkëmbore që zbrasin thikë deri ne Dri dhe nga pas shpine nga mbrojtja besnike e banorëve të Dukagjinit.

5 Në Qeresh

Me datën 15 korrik 2017, ditë e shtune, në Qeresh, u përkujtua 102 vjetori Qëndresës së Dukagjinit kundër ushtrisë Malazeze, në mujain korrik 1915, në Plan – Gjuraj. Në këtë përkujtimore morën pjesë banorë të fshatit Plan, Gjuraj, Mguulle, familjare të të renëve dhe të tjerë. Morën pjesë N/ kryetari i Bashkisë së Shkodrës, zoti Arben Gjurarj; Administratori i Njësisë Administrative të Pultit, zoti Tome Ndoka; Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", zoti Ndue Sanaj; kryetari i Shoqatës kulturore "Spani", zoti Mhill Pali, kryetari i Ansambllit "Trevra", zoti Fran Kodra e të tjerë.



100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

SAKRIFICA DHE ETJA PËR SHKOLLIN

45 VJETORI I TË PARAVE "DEFTESAVE TE LIRIMIT" NË SHKOLLËN 8 VJEÇARE, PLAN-GJURAJ

Me kënaqësi kam përcjellë shumë shkrime në gazetën Dukagjini, për arsimin në këtë zonë. Si unë, besoj se janë dhe shumë të tjerë që i lexojnë me inters këto shkrime. Është një nisëm e rëndësishme e Shoqatës Dukagjini që duhet përshëndetur dhe mbështetur me sa mundësi janë. Ndoshta duhet konsideruar një histori me shumë autorë dhe shumë vlera, të gjithë ata që kanë shkruar dhe hulumtuar në këtë drejtim. Nderim, respekt e mirënjohje për gjithë shkruesit e kësaj teme e veçmas për mësuesit tanë.

Pa qënë i fushës, pa kryer kërkime në këtë drejtim dua të sjellë para lexuesit, mësuesve dhe bashkohësve të mi disa kujtime, mbresa të periudhës 1968-1972. Dua të sjellë në kujtesë vështirësitë e asaj periudhe, mësuesit dhe brezin e parë të arsimuarëve në shkollën 8 vjeçare Plan-Gjuraj. "Deftesat e Lirimit" për herë u shpërndanë 45 vite më parë në fund qershorin e vitit 1972 dhe janë firmosur nga Prelë Shytani, i cili me një karrierë të gjatë si mësues u bë një ndër personalitetet më të spikatura të arsimit në Dukagjin dhe jo vetem. Shkolla 8 vjeçare në Plan-Gjuraj, u hap diku nga mesi i vjeshtës të vitit 1968 me një klasë të pestë. Si mjedis mësimi, shërbeu Vatra e Kultures (Kisha e Planit). Ishin djem e vajza nga Plan-Gjuraj që mbaruan shkollën fillore në atë vit, disa një vit më parë, të lindur në vitet 1956, 1957 që filluan klasen e pestë të arsimit 8 vjeçar në Plan-Gjuraj.

Ky shkrim u vonue pak, pasi doja me patjeter të takoja mësuesin e parë të shkollës Planit, z. Tefë Topallin. Ky takim u realizua nepërmjet mikut tim, ish agronom në Pult për shumë vite, Gjergj Toni i cili mban lidhje me Tefën, tashmë me banim në Tiranë. Takimi me mësues Tefën, gadi pas 50 vitesh solli kënaqësi të veçantë duke më zhytur më thellë në kujtime e asaj periudhe. Biseda për hapjen shkollës 8 vjeçare në Plan-Gjuraj, solli në vëmendje vështirësitë e kohës, vullnetin e femijë dhe prindërve të Plan-Gjurajve për shkollim, emancipimin vajzave dhe djemëve që binte në sy dhe pse ishim një zonë e thellë malore e sa po elektrifikuar, në hapat e parë të kolektivizimit. Transporti me krah i bankave të shkollë nga Ducajt e Shkrelit nepërmjet Qafës së Shtogut për në Plan, ka qënë një vështirësi e madhe ku burrat e Plan-Gjurajve e përballaun me sukses dhe pa asnjë shpërblim. Ata që njohin këtë rrugë malore këmbësore mbi 30 km, me të përpjeta e teposhta, ato banka të pazmontueshme me peshe mbi 80 kg që shërbyen për disa breza, sot duket si pamundur. Klasa e pestë dhe konvikti i parë u hapën në mjediset e Kishës Planit, deri ne vitin 1966 e kthyer si Vatër kulture në vitin 1967. Mësues Tefa, kujton se si u emrua mësues në Plan pas mbarimit të Universitetit të Tiranës dhe tre vite punë si mësues në Bardhoc të Kukësit. Shefi seksionit arsimit me thirrri thotë Tefa, "me

tregoi një hartë të Shqipërisë, në hartë ndoqëm rrugën auto Shkoder-Theth, këtu do mbarojë udhëtimi me makinë. Prej ketej u kthye në drejtim të Jug-Prendimit të Alpeve dhe më tregoi fshatin Plan, këtu do punoni ju. Është fshat i thellë por janë njerëz të mirë, malësorë bujar dhe do kalosh mirë dhe me uroj suksese. Erdha deri në Theth me makinë, prej aty pasi u takova me pergjegjësarin arsimit për Zonën e Dukagjinit; më vunë në dispozicion një mushkë dhe prej andej kam transportuar rrobat e personale dhe ato të fjetjes. Në Plan, të parin kam takur Pal Rupaj mësues i shkollës fillore në Kodër Palkolaj. Ai me krijoi të gjitha mundësitë dhe lehtësitë për banim. Shkolla fillore kishte tre dhoma, dy klasa për mësim

njerëzit që kishte njohur ne atë vite si Lulash Noshi (Arrinaj) i cili natën e dyte të fjetjes në Plan na mori për darkë me mësues Palin, ai sebashku me Ndue Pashkun (Boken) si kryetar keshilli u moren me të gjitha problemet e shkollës deri në fillim të mësimt. Nga Boksi kujtoj Lazer Pjetrin, Zef Gjelošin (Arën), Mehil Gjonin (Qershia), etj. të cilët ndihmuan fuqishëm për të filluar mesimi sa më parë dhe për të regjistruar nxënësit". Mësues Tefa kujton dhe tw tjere emra si dhe kujdestarën-kuzhinierën e parë të konviktit, Marije Shytani. Për brezin tonë të parë të nxënësve ai thote se: "Ishit shumë të përkushtuar për shkollën, me shumë edukatë dhe të sjellshëm". Tefë Topalli, ka qëndruar si mësues në Plan vetëm një vit, për të kaluar

shkolla të ndyshme të Shkodrës, si pedagog në Universitetin e Shkodrës dhe disa universitete të tjera dhe jashtë vëndit. Tefë Topalli, është autor dhe bashkautor i disa botime të rëndësishme të nivelit akademik, një personalitet me emer në plejadën e mësuesve të Shkodrës.

Mësues Tefë Topallin e zëvendësoj Dedë Mbrapshtia nga Gimajt. Klasën e gjashtë e filluam tek shkolla e re ku hapën dy klasa, aty ku është dhe sot sic quhet "Kodër e Kashutit", midis Planit dhe Gjurajve. Konvikti ka funksionuar për gjashtë ditët e javës ku jetonin nxënësit nga: lagja Kuje e Zabel të Planit dhe nga lagja Maja Thanës e Telaj të Gjurajve, të cilët ishin në largësi të madhe nga shkolla. Konvikti në vitin 1969 u zhvendos tek shtëpia e Gjon Lulës në Than, me kujdestare kuzhinierë atë që njohim si Dranja e Gjon Kokrrit. Ajo, një grua malësore e jashtëzakonshme me mundësi fizike të kufizuar, por ne konviktorëve (rreth 20-22 djem e vajza) na sherbeu për rreth dy vite si në nënë e dytë. Më vonë konvikti u zhvendos afër shkollës tek shpia e Gjon Markut të Thanit, këtu na shërbeu një grua tjetër siç e njohim ne Dranja e Pal Ndocit. Edhe kjo na shërbeu mjaft mirë. Pas dy, tre vitesh ndoshta në vitin 1974, konvikti nuk funksionoi më! Dedë Mbrapshtia ishte si drejtor e mësues gjeografie, si mesues gjuhe dhe leterisje erdhi Tahir Saliq, si mësues matematike e fizike Fitim Meta. Mësues Tahiri me trup të gjatë dhe sportiv na mësoj të luanim volejbol. Për mësues Fitimin Meten, sjell në kujtesë, pamjën dhe veshjën e veçantë. Kujtoj se tek ai për herë të parë, kam parë "pantallona kaubojs" dhe butonat e florinjët të këmishës, etj. Fitimi ishte një mësues shumë i rreptë, kërkues dhe mjaft kompetent në matematikë-fizikë. Disa lëndë i zhvillonin dhe mësues te shkollës fillore, Pal Rupa dhe Pal Kroni. Në shkollë, na mungonte çdo mjet mësimi. Kujtoj mësues Fitimin që e bënte rrethin ne drrase të zezë me dorë të lirë si me kompas, vijat i bente si me vizore, etj. Pas një viti ky u largua nga shkolla, me vonë morëm vesh se per arsye "biografie" e kishin larguar nga arsimit. Kur kemi kaluar në klasën e shtatë në vitet 1970-1971 erdhi si drejtor Prel Shytani, mësues të rinjë erdhën Rifat Isufi e Luigj Luka. Vlen te kujtoj se si keta mësues duke sfiduar cdo vështirësi, zhvillonin mesimin me mjaft nivel e korekte, zbatimi i programit mesimor bëhej me përpikmëri. Mesimet dhe detyrat ne te shumten e rasteve i benim nen driten e kandilit pasi energjia elektrike ishte me orar dhe shpesh linjat demtoheshin. Edhe pse ne moshe te re, thuajse te gjithe nxensit punonin ne ndihem te familjes, kryesisht kullosnim bagetite pas orarit te mesimit. Ne konviktoret e atyre viteve dukeshim pak me komod ne kete drejtim.

(vijon në faqen 4)



Shkolla 8 Vjeçare Plan

dhe një dhomë të vogël ku do flinim tre mësues Unë, Pal Rupaj dhe Pal Kroni. Mësues Tefa, solli kujtime dhe respektin për

në një detyrë tjetër disi jashtë profesionit si marinar për tre vite ne Vlorë. Më pas ka vazhduar rrugën e mësimdhënjes në

MËSUES DY MUAJ NË FSHATIN MGULLËPULI

“KUJDESU PËR KUJTIMET E TUA, SEPSE NUK MUND TI JETOSH PËRSËRI” - BOB DYLAN, NOBELIST

Në jetën e njeriut, dy muaj nuk zënë ndonjë vend të rëndësishëm. Por, për mua, dy muaj të fillimit të punës si mësues në fshatin Mguullë, kanë shumë vlerë. Do të përpiqem që t'i pasqyroj disa kujtime, për këtë fshat, për shkollën fillore, për nxënësit, si dhe në veçanti për familjen e Tomë Ndokës, ku unë i jetova këta dy muaj.

Mjeshtri i letra shqipe, profesori i nderuar Nasho Jorgaqi, duke folur për kujtimet, thotë: “Çdo njeri, në jetën e tij, ka kujtime të ndryshme të cilat herë të të ledhatojnë, por ka edhe nga ato që të kafshojnë. Ato janë si këmbanat që sapo i prekë, zgjohen e tingëllojnë”.

Kujtimet e mija për dy muaj të punës time si mësues më ledhatojnë. Ato i kam të freskëta edhe pse bëhet fjalë për afro gjatë dekada më parë. “Këmbanat” e mija i preku para disa ditësh kryeredaktori i gazetës tonë, e ato filluan të tingëllojnë.

1. Emrimi

Pasi mbarova shkollën e mesme pedagogjike “Ndrecë Ndue Gjoka” në Tiranë në vitin 1959, bashkë me bashkefshatarët e bashkëmoshatarët e mijë Kolë Gjoka e Lulash Gila, pritëm më gezim emrimin tonë si mësues në ndonjë nga shkollat e Dukagjinit. Edhe emrimi na doli, Kola në Lotaj, Lulashi në Pog dhe mua në Mngullë.

Siç u tha më lart, ne mbaruam atë shkollë që përgatiti disa breza mësuesishtë dhe që mbante një emër të madh, atë të komisarit të dritës, të mirditorit, Ndrecë Ndue Gjoka, të cilin e vrau errësira, pasi hapi 50 shkolla në Mirditë. Ky emër i nderuar, ishte burim frumëzimi për ne, duke e nxitur hovin tonë rinor për të punuar në çdo fshat, pa asnjë pretendim. Me 1 gusht të vitit 1959 në u paraqitëm në detyrë me shumë emocione. Për në fshatin Mguullë, e në tërësi për të gjithë zonën e Pultit nuk kish njohje.

Prezantimin tim në shkollë, para nxënësve dhe dis prindërve e bëri Toma, krietari i këshillit të fshatit. Ai e dinte gjendjen, kushtet jo të mira për zhvillimin e mësimit, mungesa të shumta nga paraardhësi im për arsye familjare, programi nuk ishte realizuar, etj. Por, ai më inkurajoi për të punuar, pasi do të kisha gjithë përkrahjen e nevojshme nga këshilli e nga prindërit e nxënësve. Edhe unë u prezantova, u thash se jam 18 vjeç, jam nga Lotajt e Shalës, e filloj mësuesinë për herë të parë. U kërkova ndihmën e tyre për të zëvendësuar kohën e humbur. Fytyrat e qeshura të atyre 13 ëndjueve që kisha përpara me gëzonin, më shtonin besimin. Mendova se puna duhej filluar nga një testim, për të parë se ku duhet përqëndruar vëmendja, sa ishte realizuar programi, sa ishte përfutur prej tij. Më rezultoi se niveli i dijeve ishte i dobët për çdo klasë e sidomos për klasën e parë që kishte tre nxënës. Kërkova ndihmë edhe

nga prindërit duke u thënë mendimin tim që fëmijët e tyre të merrnin bukën me vete për një vakt, që pasi të mbaronte mësimi të, të hanin e të pushonin pak, e pas kësaj të bënin deturat e të përgatitnin mësimet për të nesërmen nën kujdesin tim. Për këtë u konsultova edhe me drejtuesin e rrethit metodik të zonës, që ishte mësuesi i dalluar e me përvojë Gjin Kolë Avdia.

Rezultati po dukej, përparimi ishte në rritje. Prindërit filluan të jenë më aktiv, më të interesuar. Shkolla filloi ndryshimin edhe në pamjen e saj nga lyerja me gëlqere, paisja me xhama, me disa mjete mësimore që i përgatisja vetë. Kështu vazhdoi puna për dy muaj, pra gushtshtator, e ajo u ndërpre nga transferimi

Ishte një djalë i ri, trup mesatar, bjond, i pashëm dhe shumë komunikues. Ai na njohu me shkollën, me fshatin dhe në fund me shtëpinë e tij, e cila ishte më pak se 100 m nga shkolla. Buzëmbërëja po afrohej. Pyetjes tonë se unë ku do të jetoj ai na u përgjigj “sontë në shtëpinë time, nesër ditë e re nafakë e re”. Na priu përpara e ne pas tij. Sapo mbrritëm në shtëpinë e Tomës, ai foli i pari, ky është mësuesi i ri, sonte kemi miq. Nga ana tjetër na prezantoi me nënën e tij të moshuar, por e mbajtur, me mërin Dikë, bijë Sume, nga një truall i përmendur për mirë, vazhdoi me gruan e tij, një nuse e re me emrin Dilë e cila kishte prabnë Gjergjin e vogël 4 vjeç.

Filluan urimet, ne “mirëse ju gjetëm”,



Tomë Ndoka me bashkëshorten Dila

im (për arsye familjare) për në shkollën fillore Lekaj-Shalë.

2. Shtëpia e Tomës

Siç thashë edhe më parë, unë kaloja për herë të parë Qafën e Boshit. Edhe rrugën nuk e dinim. Deri në Plan në udhëhoqi mësuesi i këtij fshati Ndue Qerimi (Quku), i cili edhe ai kishte mbaruar të njëjtën shkollë si unë, por një vit më parë. Mua më shoqëronte nëna imë me merakun se ku do punoj, ku do të jetoj, si merakun i nënës për fëmijën e vet që e ka rritur me halle të mëdha si jetim që ishte.

Rruga nuk që aq e shkurtër sa dukej nga Plani. Sa kaloje një kodër paraqitej një luginë për tu ngjitur në një kodër tjetër. Më në fund arritëm në oborrin e shkollës. Ishte në një potolok i bukur, një ndërtesë një katëshe e ndarë në dy pjesë, njëra për shkollë, pjesa tjetër për kishën ku kryheshin shërbesat fetare nga frati i Kirit. Në oborrin e saj një bli i madh. Dy tre nxënës që po luanin në oborr, kur na panë, pa na pyetur fare, thirrën me të madhe “na erdhi mësuesi”.

Ata fëmijë, me kërkesën tonë, lajmëruan Kryetarin e Këshillit, i cili erdhi menjëherë. Tomë Ndoka më quajne.

ata “mirse ju pru zoti”. Pas këtyre u ulëm në sofrën e tyre bujare, ashtu siç din malësori ynë, me “bukë e kripë e zemër”, por në fakt sofrë ishte plot.

Filloi njohja më e hollësishme. Mësuam se Toma ishte rritur nga nëna e tij jetim, pasi baba kishte vdekur në moshë të re. Natyrisht edhe nëna e Tomës kishte mbetur e ve në moshë të re. Ajo përballoi vështirësi të panumërta deri sa Toma u rrit, i doli zot shtëpisë. Si djalë i ri dhe i shkathhtë që ishte fillimisht punoi si instruktor rinie për zonat malore e më vonë, për të qenë më afër nënës dhe nuses së tij, Toma filloi punë në sektorin e puyjeve dhe me detyra shoqërore e së fundmi Kryetar i Këshillit për fshatin.

Dika dhe nënë ime, herë njëra dhe herë tjetra, ndërronin historitë e jetës së tyre plotë vuajtje, halle e vështirësi për rritjen e fëmijëve të tyre.

Erdhi momenti që në këto kujtime të përfshihej edhe nusia e Tomës. Vetë emri i saj, Dilë, nënës time i solli një shimbje duke kujtuar emrin e vajzës së vetme te vdekur në moshën 9 vjeçare, por që më vonë e mblodhi veten duke ju drejtuar “Dilo”, ashtu siç i thërriste vajzës së saj. Kështu kaluan orët e asaj nate të

paharruar, duke vulosur një shoqëri të re midis dy grave të përvuajtura, por që ishin krenare si e kishin përbadhur jetën duke rritur djentë e tyre.

Në këtë shtëpi ta vogël, unë kalova një natë të paharruar, por që ajo vazhdoi për dy muaj të tjerë, duke më trajtuar si një pjestarë të familjes së tyre.

Dy muajt e qëndrimit të punës në Mguullë, do të mbeten të paharruara. Respekti për mua, jo vetëm nga nxënësit e prindërit e tyre, por edhe nga banorët e fshatit, ishin tregues i atyre cilësive e tipareve të traditës burrërore, mikpritjen e malësorëve tonë. Më pëlqentë kur ata më thërrisnin “o djali i Shalës”.

Për vetë kohën e shkurtër të qëndrimit tim në fshatin Mguullë, nuk pata mundësinë e njohjes e të komunikimit me njëzëit, me banorët. Por po veçoi një rast kur unë dola para “auditorit” të banorëve për herë të parë. Toma hapi mbledhjen dhe menjëherë tha fjalën e ka mësuesi. Unë i skuqur deri të veshët, u ngrita, fola ashtu si i “trullësuar”, por dashamirësia e njerëzve dhe duartrokitjet, ndoshta të pamerituara, por shpejt u çlirova prej tyre kur më uruan “të lumtë goja djali i Shalës”. Kënaqësi për mua ishte e madhe, sepse kalova “provincin e parë”, nëkomunikimin e parë me banorët.

Siç thash më lart, unë në shtëpinë e Tomë Ndokës shkova për një natë dhe qëndrova dy muaj, deri erdhi transferimi im. Në këtë familje gjeta dashuri e respekt të madh, gjeta njerzillëk, gjeta dy gra, nuse e vjehërr që flisnin me njëra tjetrën me respekt të madh, me dashuri të madhe. Dika për djalin dhe Dila për bashkëshortin, idhulli i tyre që ishte Toma i rrethuar kurdoherë me një atmosferë gazmore prej tyre, dhe nga Gjergji i vogël. Dila një kreshnike e vërtetë, e vuajtur, por e pamposhtur nga përplasjet e dallgëve të jetës, e papërkulur maksimalisht, për të dhënë ndihmën e saj që të përparojë dhe të lulëzojë familja e djalit të saj, prandaj qëndronte e fortë edhe pse në moshë të thyer, shumë gazmore, shumë e pastër, “me marrë blea mjaltë në të”, siç thoshte një bashkëkohës i saj. Këto vlera, reja e saj Dila i përpinte me dashuri, ia dintë për ndër atëherë, kurse sot me dy fjalë thotë pas kaq vitesh “shpirti i saj baftë dritë”.

Edhe sot, pas afro gjashtë dekadash unë, “djali i Shalës”, përkulem me respekt të thellë për Dikën, për familjen e vetë Tomën, për gjithçka bënë për mua gjatë dy muajve të qëndrimit të punës në shkollën fillore Mguullë. Gjithnjë mbeta borxhli ndaj kësaj familje, por asnjëherë nuk më mungon mirënjohja për ta.

NDOC GRIMAJ

(vijon nga faqja 2)

Është me rëndësi të kujtoj se krahas mesimit për ne nxënësit e dites u hap dhe "Shkolla e mbremjes". Ishin burra dhe gra nga Plan-Gjurajt që ndonëse kishin kaluar disi në moshë u regjistruan në shkollë 8 vjecare. Ishte pasioni dhe dëshira pa kufij për dituri, i beri të sfidonin moshën dhe cdo vështirësi për shkollimin. Mësuesit jepnin mesim tre herë në javë pa pagese për këta nxënës të "shkollës natës". Dua të kujtoj disa nga ata që mësuan në ato vite si: Lulash Noshi, Ndue Vata, Prek Deda, Gjon Vata, Lek Mhilli, Zojë Shpenja, Age Mehilla; Lazer Pjetri, Ndue Deda, Mark Luca, etj. Kështu ju thërrisnin në ato vite, në emrin e babait si mbiemer.

Shkolla e Planit u bë një pikë takimi, qëndër e rëndësishme, jo vetëm shkollimi por dhe zhvillimi të gjithanshëm të fshatit. Prej aty u filluan shumë nisma e aksione për; higjenizimin, lyrjen dhe rregullimin e banesave, të rrugëve, të mbrojtjes së linjave elektrike, etj. Nga viti 1972, deri në mesin e viteve 90 të shekullit kaluar nga kjo shkollë dolën me dhjetëra nxënës të ditur dhe me kurajo çanë rrugët e jetës brenda dhe jashtë vendit. Krenaria dhe nxënësi simbol i shkollës 8 vjecare Plan-Gjuraj është Lazer Stani sot shkrimtar. Ai është sot një nder prozatorët më me emer në letërsinë shqipe të ketij fillim shekulli. Nëse shkolla 9 Vjecare Plan-Gjuraj do të funksiononte normalisht në mësimdhënie dhe të frekuentohej nga nxënësit, do të që një nder i veçantë të mbante emrin e "Lazer Stani". Ai ka mësuar në brezin e tretë të shkollës në periudhën 1970-1974. Në shkollë, kujtoj se filluan të thërrisnin njeri tjetrit me mbiemrat që kishim në certifikatë dhe

në regjistër, pasi deri atëhere thërrisni si mbiemer në emrin e babës. Ne brezi i parë, nuk patëm mundësi të kishim në shkollë në katër vite; një laborator apo kabinet, bibliotekë e paisje për vizatime dhe shkumësat i kishim me numër dhe shpesh na mungonin. Kujtoj se diku në klasë të shtatë, na solli dy vizore mjeshtri i drurit Gjon Dermani nga Gjurajt; një kompas, trekendesh dhe raportor druri na i solli, Zef Kol Plavra nga Mahalla. Ishin të pakët ata që kishin bibliotekë dhe libra në fshat. Librat artistik filluan të silleshin në fshat së shumëti nga ata që ktheheshin nga ushtria dhe mësuesit. Kujtoj se në klasën e gjashtë lexova një "liber të verdhe" kështu quheshin atëhere; novelën "Lulet e mollës", ma solli kushirri im Pjetër Shkëmbi, unë e lexova me një frymë, ja dhashë shokut tim Mehil Shtogu dhe kështu libri kaloi në disa duar në shkollë. Pjetër Shkëmbi e kujtoj si pasionant të madh të leximit dhe librave në ato vite, por asnjehere nuk pata guximin ta pyesja nga i merrte që na i sillte jo vtem mua por dhe disa te rinjëve të tjerë. Ai na solli dhe libra të tjerë që unë dhe disa shokë i lexuam në klasën e shtatë dhe të tetë, kujtoj romanet; Lumi i Vdekur; Lulja e Kujtimit; Për mbrojtjen e atdheut; Tradhëti, etj.

Ne dhe pse ishim brezi i parë, pak vetave ju mundësua shkollimi i mesëm dhe shumë më pak ai i lartë, ndonse kishim shumë kërkesa dhe shumë prej nesh aspironim për shkollim të lartë. Në vitin 1972, u shpërndanë bursa për këto shkolla të mesme repektivisht: Gjyste Shpati -Shkolla e Mesme Mjekësore Shkodër për farmacistë; Gjyste Hutinaj, Shkolla Bujqësore Kopluk si agronome;

Pal Leraj-Shkolla e Mesme Ekonomike Lezhë për financier; Dedë Kodrina Shkolla Mesme Skenderbej Tiranë për oficer; Gjon Fierza, teknik pyjesh, Shkolla e Mesme Pyjore Shkodër; Zef Shkrepi, teknik ndertimi Shkolla e Ulet e Ndertimit, Shkoder. Nga brezi yne vazhduan studimet e larta: Pal Leraj dhe Gj. Fierza ne deget e tyre. Edhe ne vitet e mevonshme mundësitë për në shkolla të mesme dhe te larta kanë qënë të kufizura dhe në dege jo të zgjedhura. Shkolla e Mesme Bujqësore që u hap në Breg-Lumi që një mundësi e krijuar për një shkollim më masiv për agronomë. Kujtoj, Lazer Stani ka mbaruar, Shkollën e Mesme Veterinare Shkoder, kur mendoj se ai kerkonte shkollën pedagogjike apo mjekësore. etj. Dua të kujtoj një bisedë me një shokun tim nga Vlora kur mesoja në Shkollë të Mesme Pyjore. Po diskutonim për shkollimin dhe çfarë dëshironim të shkolloheshim. Unë i thashë kisha dashur të mësoja për: mesues, mjekësi, etj.!? Ai me tha se tek fshati im në Lumin e Vlorës në përgjithësi thujse na plotësohën të gjitha kërkesat. Kam dëgjuar nga babai se çdo vit vjen me një qellim të veçantë njeri nga drejtuesit e lartë të Byrorse Politike të PPSH me origjinë nga ana jonë. "Ai jepte porosi që të gjithë djemte e vajzat do shkollohen. Ju kerkonte atyre të këshilli të fshatit të caktonin deget kryesore dhe numrin e atyre që do shkojnë në shkolla të mesme dhe të lartë cdo vit. Pra çdo djalë apo vajzë që mbaron 8 vjecarën do vazhdojnë shkollën e mesem dhe të lartë. Ka pasë raste që janë "djegë bursa" tek ne. Tek degjoja këtë bisedë, solla në vëmendje me sa vështirësi dhe sa pak veta u mundësohej ne ato vite jo vetëm ne

Plan por dhe në Dukagjin shkollimi dhe aq më pak në profesione të zgjedhura. Sigurisht ishte një pakudësje deri në diskriminim e pushtetit të kohës; vonë, me shumë vështirësi dhe sakrifica shumë dukagjinesit e gjetën dhe ndoqën rrugën e dijes.

Në mbyllje të këtij shkrimi po sjell në kujtesë emrat e bashkënxënësve; në shënjë respekti dhe mirënjohje si brezi i parë i Shkollës 8 vjecare Plan-Gjuraj, si homazh për ata që ka ndërruar jetë. Në se ndonjerin e kam harruar ta listoj, nuk kam permendur ndonje mësues dhe shumë veshtiresi dhe ndodhi te atyre viteve; ju kerkoj të falur. Kanë kaluar 45 vite, jeta dhe puna larg vendlindjes e ka bere punen e tyre tek kujtesa ime. Ka disa shokë dhe shoqe, që nuk kam mundur ti takoj me që në vitin 1972. Sipas regjistrimit klasa V-te 1968 listohej: Dedë M. Kodrina; Fran Gj. Mani; Gjon M. Fierza; Gjyste T. Hutinaj; Gjyste K. Shpati; Kolë Gj. Mullini; Kushë P. Thana; Lazer P. Lari; Zeze M. Rrush; Mark Z. Ara; Martin Gj. Lisi; Mehil N. Shqarri; Mehil P. Shtogu; Pal P. Leraj; Pashke Gj. Leka; Pashko D. Qarku; Shan N. Ftoni; Tereze N. Boka; Zef N. Shkrepi; Zef N. Shpati; Zojë P. Rrasa. Gjithnjë në mendje dhe zemër më ka mbetë vendlindja me njerëzit që njoha apo punova sado pak, por bashkëmoshatarët e mi zënë një vend të vecantë!

U përpoqa të kujtoj me modesti diçka nga ajo periudhë e arsimit në Plan-Gjuraj, pa qënë shteruese, ku shumë të tjera mbetën të pa thëna.

Përgatiti **Gjon Fierza**, ish nxënës i kësaj shkollë

*** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi ***

DUKAGJIN, KËSHTJELLË E QËNDRESËS

Me qëndresë shekujt kaluan,
Dukagjinin se harruan,
Sot t'u ligjruet merita jote,
Luftrat që përballlove në mote,
Dekorata e nderit po të ndritë,
Kurrë, në shekuj s'ka me u fikë,
Në ato kulla e ato kreshta,
Ku ish lufta e qëndresa,
Gjaku u derdhur për troje e liri,
Shkrue n'flamurin kuq e zi,
Ngjyrë e kuqe me shumë vlerë,
Me patriot e shqiptarë të tjerë,
Që dhanë jetën për besë e nderë,
N'shekuj luftove, e mbete trime,
O Dukagjin zemra ime,
"Populli i urtë thotë:
Zoti vonon por kurr nuk harron",
Kështu koha po vepron,
Kush qëndron për vend të vet,
Vlera burrave kurrë s'ju tretë,
Ne dukagjinasi në mërgim,
Mësuan një lajm si befasim,
Kur pamë në ekran atë dekorim,
U mbushen zemrat plot gëzim,
Shume urime e përfaqime,
Dekorimi i vlerës së vërtetë,
Erdhi në marsin dymijëeshtambëdhjetë,
Në histori, kjo datë mbetë,
Ceremoni me vlerë, plot emocione,
Për populli trim të kësaj zonë,

Është krahina e Dukagjinit,
I jepet titulli i nderimit,
Një populli shumë të nderuem,
Sot n'altar mbetet i shkruem,
Në altarin e historisë,
Në piedestalin e pavdeksisë,
Për qëndresë i doli nami,
E njohu Krajlji, Mbreti e Sulltani,
I deshi trojet si nënë e babë,
Amanet të parëi na i lanë,
S'mundet kush me ia zanë,
Qëndroi kështjellë e levdisë,
Ndër i dhanë gjithë Shqipërisë,
Diel fort aty po shëndritë,
Mbi Dukagjin, për meritë,
Po nderohen huta e berdana,
E manxerret me gjerdana,
Dhe jlekët me xhamadana,
Lum për djemtë që lindi nana,
Mbushur gjokset me nishana,
Për nderim vlerat e burrit,
Rrinë si shqipe në ballë t'flamurit,
Luftën e bani me ndërshëmni,
As për grada, as për pasuni,
Por për vatan e për liri,
Nga krahinat e tjera u dallove,
Besë e armë kurr s'i lëshove,
Je burrneshë me aftësi t'madhe,
Heronj trime shkruet n'lapidare,
Fjala jote u ndigjue,

N' krye të vendit i respektue,
Pate n'shekuj emër madhor,
Identitetin e ruajte me armë n'dorë,
Dekorimi "Nderi i Kombit",
Nderim brezash, që n'kohe të Kastriotit,
Të gjithë popullin e kësaj krahine,
Ajo bujare, besnike e trime,
Lindi e rriti burra atdhetarë,
Të nivelit ndër kumbëtarë,
Poet, artista e shkrimtarë,
Diplomat dhe shkencëtarë,
Burra pende e të mendimit,
I naltësuan vlerat Dukagjinit,
S'i munguan kurrë burrat vendit,
Përaqësues n'Lidhje të Prizrenit,
Në këtë festë të përrurimit,
Në veçanti një burrë Dukagjinit,
Titulli lartë "Nderi i Kombit",
Kishte gradën e profesorit,
Asht Kolë Prela n'Pepsumaj të Shoshit,
Politikan dhe atdhetar,
N'Dukagjin, deputet i parë,
Në lëvizje ishte përrfshi,
Për fjalën e lirë në Shqipni,
Grup deputetësh patriot,
Që e deshtën Shqipninë fort,
Por diktatura pa arsytim,
I dënoi me pushkatim,
Me kushtetutën e padrejtësisë,
Mos t'harrohen burrat në shekuj,

Për këtë titull të vlersimit,
Ka meritë falnderimi,
Shoqata "Atdhetare Dukagjini",
Do t'kendohen n'lahutë të vjetër,
Punoj shumë me përkushtim,
Me ndërgjegje e pa shpërblim,
Historisë i bani rifreskim,
Ju dha ngjarjeve shumë randësi,
Vite e data me saktësi,
Po punojnë me përkushtim,
Episodet pa mbarim,
Për përparimet në Dukagjinit,
Jehonë po i bajnë historisë,
Njoftuni me i dhanë rinisë,
Boton libra e gazeta,
Me i njoftë krahina vlerat e veta,
Kushdo shkruan i jep vlerësim,
Për trimat e vendit tim,
Merr respekt dhe falnderim,
Sado pak në këtë ekspozim,
Shfaqja ndjenjat e shpirtit tim,
Të gjithë bashkë po festojmë,
N'unitet si gjithmonë,
Kështu brezat i nderojmë,
Qofshin t'lumtun dhe të nderuem,
Të gjithë ata që kontribuan,
Për vlerat e shekujve të kaluem.

Maj, 2017
PIETËR GERA
Bruksel

Në Qeresh

Me datën 15 korrik 2017, ditë e shtune, në Qeresh, u përkujtua 102 vjetori Qëndresës së Dukagjinit kundër ushtrisë Malazeze, në mujain korrik 1915, në Plan – Gjuraj.

Në këtë përkujtimore morën pjesë banorë të fshatit Plan, Gjuraj, Mgulle, familjare të të renëve dhe të tjerë. Morën pjesë N/ kryetari i Bashkisë së Shkodrës, zoti Arben Gjuraj; Administratori i Njesisë Administrative të Pultit, zoti Tome Ndoka; Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, zoti

Ndue Sanaj; kryetari i Shoqatës kulturore “Spani”, zoti Mhill Pali, kryetari i Ansambllit “Treva”, zoti Fran Kodra e të tjerë.

Pranë Lapidarit kushtuar të renëve në këtë Qëndresë u vendosën kurora. Në emër të familjareve të të renëve, vendosi Kryeplaku i fshatit Plan, zoti Pjeter; në emër të Bashkisë Shkodër nga zoti Arben Gjuraj e Tome Ndoka; në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” nga Ndue Sanaj e Vat Gjoni; në emër të Shoqatës

“Spani” nga Mhill Pali e Fran Kodra.

Ceremoninë e hapi, Kryetari i Shoqatës Kulturore “Spani”, zoti Mhill Pali. Në emër të Bashkisë përshendeti zoti Arben Gjuraj. Në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, përshendeti Ndue Sanaj.

Ata që përshendeten mbi të gjitha theksuan, se ne sot dhe përherë, në fakt nderojmë veten, se ata e kanë kryer detyrën e tyre ndaj bashkësisë, ndaj atdheut, me gjakun e tyre, me jetën e tyre për liri e pavarësi. Detyra e jonë është, që ti respektojmë këto sakrificat, se duke respektuar gjakun e jetën e tyre, respektojmë veten tone. Ky respekt, ky nderim duhet të trashëgohet brezave.

Pas vendosjeve të kurorave dhe përshendetjeve të rastit, nga vendi ishte përgatitë për miqtë një drekë me plotë llojshmëri ushqimore.

Këngëtarët e ansambllit “Treva”, me Kantautorin Fran Kodra, me këngëtaurin e mirëjohur Ndue Shytani dhe me fizarmonike, Ndok Leka, me këngët e tyre krijuan një atmosferë festive dhe e mbajtën mjedisin gjallë gjatë gjithë kohës.

Kjo veprimtari përkujtimore u mundësua nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Voltana Ademi, të cilën e falenderojmë përzemërsisht.

Korespondenti i gazetës “Dukagjini”



Si u ndërtua Kisha Françeskane në Shkodër me dekret të sulltan Hamidit

(Nga ditari i PJETER LOGORECIT)

Ballabane quhet ajo zonë e qytetit të Shkodrës, (në mes Serreqit, varrezave të Rrmajit, Gjuhadrës dhe Dugajve të reja), prej ku dolën personalitete shqiptare të kulturës, të rangut kombëtar. Personalisht, isha me fat që linda dhe kalova fëmijërinë në këtë lagje, në një kohë (brez) që pat mundësinë e fundit të kishite kontakte me këto korife të atdhetarisë e kulturës.

Vetëm në një hapsire të vogël të kësaj lagje jetuen figura si: personazhi i shkrim-it tim Simon Rrota, gjuhëtari dhe diplomati Kolë Rrota, at Justin Rrota, fotografi Gjon Rrota, mjeshtri i futbollit Loro Borici, mjeshtri Kolë Shiroka, aktori Bep Shiroka, kompozitorët e klasit të parë Cesk e Tonin Zadeja, Tish e Tonin Daija, arkeologu i mirënjohur Frano Prendi, këngëtar i talentuem Tonin Tërshana, intelektual i dorës së parë Cuk Simoni, atdhetari Luigj Gurakuqi, gaztori i njohur shkodoran Filip Daija, Kardinali Mikel Koliqi dhe vëllai i tij Ernesti, Kleriku Dom Simon Jubani, Mons Fishta, Mons Coba, At Pjeter Meshkalla, At Leon Kabashi dhe (banoj për disa vite) familja e shejtores Nënë Tereza.

Po këtu kaluan fëmirinë dhe personalitetet e një brezi më të vonëshëm si: violinisti me famë Lorenc Radovani, basi i njohur në mbarë botën Frano Lufi, historiani Romeo Gurakuqi e të tjerë.

Për banorët e lagjes time, shtëpia e familjes Rrota (një ndërtesë e stilit alpin), përbënte një veçanti. Me paraqitjen e saj të jashtme, kjo shtëpi sillte pranë nesh atmosferën e kulturës përendimore, ndërsa e mbrëndeshmja e saj kuriozonte të gjithë me praninë e kryeveprave të Simon Rrotës dhe personalitetin e gruas së tij italiane, Zonjës Karla. Pata rastin dhe fatin, kur isha në moshën e fëmijërisë, të njihja piktorin Simon Rrota dhe pjestarët e familjes së tij, djemtë Rafaelin e Toninin e vajzat Albinën dhe Norën, të cilët ishin shembull të mirësjelljes dhe model qytetarie, e me pas nipat e mbesat, që jeta e solli të jetojnë sot jashtë vendit. Sot një pjesë e Ballabanës, vendi ku jetoi piktori i madh shqiptar, mban emrin Simon Rrota.

Në këtë numer të suplementit Eilindasi sjellim sot pjesën e tretë me fragmente të zgjedhura nga ditari i piktorit Simon Rrota.

PJESË NGA DITARI

... Ishte vjeti 1902 kur Pater Francesco da Bieno, na lajmëroi, te dera e Kuvendit të fretenve, se Sulltan Hamidi, kishte çue firmanin (dekretin) për me lanë të lir fretnit me vazhdue punimet për ndertimin e Kishës të tyne e cila, tash sa vjetë kishte mbetë gadi për gjysë, pa u mbarue. Qyshë bë fillim pati gjetë kundërshtime të mëdha, jo aq prej qeverisë turke, por prej këtyne të vendit (myslimanëve të Shkodrës) qi prej injorancës të zakonshme, kundërshtojshin vëllaznit e tyne kristjanë. Për këtë arsye, mbasi kishin

fuqinë në dorë e influencë pranë qeverisë turke, nuk e patën të vishtirë me ndalue punimet e me e lanë Kishen në një gjendje të mjerueshme për shumë vjetë.

Por çdo kohë ka evolucionin e vet e, mbas sa vjetësh, ata qi dikur kishin gjykue qi ajo ndërtesë mos t'u godiste, kishin dekë

e brezni tjera jetojshin në Shkodër e jo me aq kërcnime si ata të parët e tyne. Kur morën vesh se zyrtarisht Sulltani i Stambollës (Istanbul-Costantinopoli) kishte dhanë urdhën me anën e firmanit, atëherë nuk banë ma za, dhe se mentaliteti i tyne kishte ndrrue e se urdhni i Stambollës nuk mund të kthehej mbrapshtë e se ky vendim ishte i qindrueshëm.

Me pak fjalë, Pater Francesco, qi me zëll të madh e kishte marrë përsipër ndertimin e ndërtesës, shtini puntorët, qi ishin të tanë myslimanë prej Dibret të Madhe (sot në maqedoni) pse muratorët vendas ishin shumë te paktë. Mirëse puntorët filluen punën, por me çka me i pague? A thue vetëm me 150 grosh qi gjetën në kasetat e kishës provizore të improvizueme në Kuvendin e françeskanëve do t'i bahej ball shpenzimeve? Këto fjalë i ndjeva prej gojës të Pater Francesco-s, i cili ishte ndejë te korridor i Kuvendit, tue kja hall me fretnit tjerë qi ishin aty rreth tij. Në këtë rasë kaq të ngushtë, kishte një trazim të madh në vedi, mbasi ndihma prej kuj nuk kishte, përveç Zotit, e se me ndihmën e Tij, Kisha do të përfundonte së ndertuemi ma së mirit e me u mbëkambë, ashtu si asht sot.

Më bjen ndër mendë se na, si djem të ri, shkojshim me ndihmue me bajtë gurë së bashku me xhakojt (seminaristat – ata qi vazhdojnë mësimet për me u ba meshtarë) e fretënve. Po ashtu edhe prej anës së popullit nepshin ndihmë vullnetarisht e pa pritesë, mjaft qi ndertesa të vazhdonte simbas një planit qi kishte lanë njëfarë Fra Anselmo. Por njëkohësisht u banë disa ndryshime, me kërkesën e fretenve, e këto i bani ingjenier Brijoti (francez në shërbim të Otomanëve) i cili ma vonë u ba vendas e u martue me një grue shqiptare, por nuk lanë trashigimtarë.

Ndertimi i Kishës, qi zgjati ma se katër vjetë, përfundoi me 8 dhetuer 1905, ditën e Zojës së Papërllyeme (Immacolata Concezione) dhe u ba inaugurimi me një ceremoni të madhe. Kumpanjeli (campanile) u ba mbas një vjetit, por kumbonët kishin mbetë në doganë e simbas zakonit të gjithmonshëm, këta të vendit (myslimanët e Shkodrës) nuk lejoi shin me i dhanë, prandej kaloi një kohë e gjatë me grindje të palëve; por ma në fund, konsulli i Austrisë, u muer vesht me Valine e Shkodrës i cili dha urdhën qi kumbonët të dorëzoheshin sa ma parë.

Transportimi i kumbonëve dha pak mundim për me i prue në qytet, pse vetëm kumbona e madhe peshonte 600 kg. nder sa dy të tjerat ishin ma të lehta pse ma të vogla. Bajtjen e tyne e mori përsipër Gjokë Prendushi, i cili i vuni qerres dy palë që për tërheqje, e përcjellë prej popullit qyshë prej doganet (qi atëherë ishte afër Urës Bunës) e deri në qytet, si ngallnuesa prej gëzimit. Mbas pak kohet u ba edhe ceremonia e zakonshme e pagzimit të tyne (kumbonëve) e si nun ose kumbarë, kje Imzot Lazer Mjeda Arqipeshkvi Metropolit i Shkodrës.

Me rasën e ndertimit të Kishës së fretenve, edhe myslimanët e Shkodrës nder-tuen xhaminë e Fushë Qelës (në pjacë) tue prishë atë të vjetrën qi isht shumë e keqe dhe e pa bukur, ndersa kjo e reja u ba shumë ma e mirë dhe e bukur, sidomos minarja e punueme me gurë të latuem e paraqitet, si

stil, si kumpanjeli i Kishës së fretenve, dhe doli i fortë e i bukur nga ana arkitektonike. Megjithëse në vjetin 1905 ra termeku, Kisha nuk pësoi aq shumë damtime përveç do plasave murit qi ma vonë i mbyllën me çimento.

Për inaugurimin e Kishës, Kolë Idromeno, bani një vepër mjaft të bukur te elteri (altare) i madh: do rë me disa engjui qi edhe sot një pjesë e tyne ka qindruet e pa-prishun. Elteri i Madh asht një dhanti (dhuratë) e Franz Joseph-it (perandori i Austro-Hungarisë) qi ia dërgoi fretenve si kujtim. I bukur, por, tue kenë se në njanën anë të ballit të elterit ishte gëdhenë shqiponja, simbol i Shtëpis Hasburgëve (discendenza della Casa Imperiale d'Austria), Pater Francesco dhe të tjerë kundërshtuen shumë tue thanë se Kisha ishte goditë me ndihma të bamirësve të popullit e jo prej Austrisë.

Kjo gja i vajti në vesh konsullit të Austrisë, në Shkodër, i cili mbeti shumë i fyem për këtë gja. Me mundësitë qi ky kishte në atë kohë, mbërriti me anën e autoriteteve kishtare, me e transferue (Pater Francesco-n në Venedik (Venezia) ku qindroi disa vjetë, por ma vonë kthei prap në Shqipëri. Virtytet e mira qi ai kishte e për simpatinë e madhe qi Shkodra kishte për te, mbërriti me u ba l'peshkvi (Vescovo) i Djoçezit të Durrësit, por si l'peshkev, nuk jetoi shumë e trupi tij u vorruet në Kishën e fretenve në Shkodër, ashtu sikur ai dishronte, pse sa ishte në Venedik, thonte se eshtnat e vet, donte me i lanë në Shkodër, në atë vend ku ai ndertoi e la kujtime të mira e të paharrueshme në popullin tonë.

Duhet me dijtë se fretnit, patën kenë të shtërguem me lirue refetorion (sallën e ngranjes) e tyne qi asht edhe sot e ky lokal sherbei 25 vjet si Kishë për me krye nevojët e popullit për sherbime fetare, deri sa u ndertue kjo Kisha e sodshme.

Më bjen ndër mendë mirë se aty, unë e vëllau jem Justinin, kemi marrë për të parën herë kungimin, së bashku me gjithë shokët e shkollës, në vjetin 1898.

Por një episod ma të interesantshëm më ndodhi me pa po në këtë Kishë kur ishim tue pa meshë. U paraqitën dy gra me flokë të shprishun e, si të disprueme bërtitën me za të naltë tue thanë: u mbyll pazari e na lëshoni fëmijët tonë. Njana prej tyne ishte e ama e Dr. Ndoc Kicit (mjek veterinarë) e tjetra Drandja (Roza) e Kolë Merleci. Mjaftoi ky lajm me dhanë kushtimin si të ishte një rrufë e i pari të mbramin se priste e të gjithë si kjemë në Kishë, ikëm prej friget, pa kuptue se çka donte me thanë mbyllja e pazarit. Kur dolëm në rrugë, një livizje të madhe të njerëzve qi ngitshin andej-këndej; u qetsuem vetëm njatë herë kur pashë nanën teme me çarçaf në krye, qi na kishte dalë para për me na çue në shtëpi e me na hjekë frigën. Por ishte e kotë pse shpejt filluen me ra pushkë me shumicë e na si fëmij, kjaishim prej friget të madhe qi kishim, nga ana tjetër, myslimanët (e Shkodrës) ishin egërsue shumë kundër kristjanëve për arsye se i kishin dhunue Xhaminë e Rusit (në lagjen Rus Maxhar, në rrugën qi shkohet për Kopluk), tue shti mbrendë në Xhami, një thi (derr) të mbyttun. Pra, si gjithë herë, edhe kësaj herë, për çashtje fetare, ishte shkaktue një ngatrrësë e madhe në të dy anët. Myslimanët ishin shumë të

shqetsuem për këtë gja pse tepër e randë për ta, ishte dhunimi i Xhamisë aq keqas, qi nuk ka ndodhë kurr në Shkodër.

Shkaku i këtyne ngatrrësave erdhi pse ishin hjekë disa kryqa vorresh pranë Kishës së Shën Mëris (Marisë) në Kurt? Qeverija Turke, për me fashitë punë, vendosi në atë vend një kryq, me ceremoni të madhe, por mbas 9 ditësh, ai kryq u hoq prap. Për këtë arsye, malsorët, u zemruen tepër e, për hakmarrje, banë atë dhunim në Xhaminë e Rusit.

Sido kjoftë, puna shkoi keq. Myslimanët caktuen me i ra anës kristjane, sidomos kah lagjja Ballabane (pjesa e rrugës qi prej Kishës Madhe të çon te vorret katolike), me qellim qi me ba ndoj shpërdorim në Kishën e Madhe (Katedrale). Por, në këtë lagje, një farë Gasper Mazit me Tomë Prendushin, kishin zanë një pozitë të mirë te muri i oborrit të shtëpisë të Shan Shantos (në rrugën qi të çon në vorre e afër shtëpisë tonë) të cilët, të forcuem mirë me pushkë e me shokë, nuk lejshin me kalue muslimanët aty pari. Por ngjarja, nuk do të mbaronte me kaq pse, pari katolike e Shkodrës, kishte vendosë qi, në rasë rrezikut, me thirrë malsorët simbas bajrakëve (në bazë zonash ku ata jetojnë) me zbritë në qytet, sikur e kanë pasë zakon gjithëherë me i ardhë në ndihmë qytetit; por Arqipeshkvi Metropolit i Shkodrës, Monsinjor Guerrini, e ndaloi hovin e malsisë, pse e shihte të arsyeshme qi të mos shkakohej një luftë civile e me u derdhë gjak kot pa farë qellimit patriotik, e me të vërtetë do të ishte kenë një marri me pasë ndodhë një masakrim vëllaznuer i padobishëm. E bash për këtë arsye, Sulltan Hamidi, i dërgoi Monsinjor (Imzot) Guerrini-t, një kryq arit, si shpërblim se kishte ndalue një gjakderdhje të kotë, ndër dy anët.

Kështu filluen me u fashitë punët, e, pushkët nuk u ndijshin ma në qytet; me ngadalë, filluen tregtarët me hapë dugajët e tyne e me shikjue punën ma vonë, kje lidhë një besë e fortë ndërmjet myslimanëve e katolikëve, tue u betue me shoqi shojnë, mos me trazue ma as Kishë as Xhami, por me jetue vllaznisht si përpara. Besa e lidhun zuni vend, e pazari, pa vonesë u çil e puna e tregtija filloi me një aktivitet të gjallë.

Kishte kalue shumë kohë pa punë e një shumicë e madhe mallnash kishte mbetë pa u terhjekë në doganë prej t'interesuemeve, prandej të gjithë dishroshin punën e fitimin. Njëkohësisht edhe shkollat u hapën e na, si fëmij, kalojshim pa frigë mbasi nuk shifshim ma atë livizje revolucionare të asaj dite të shtundë.

Duhet me dijtë se, në këtë rasë, qeverija Turke, për me mbrojtë kristjanët nga rreziku, pat shpërndaj ushtrinë e vet, ndër të tana lagjet e qytetit, me çadra e për një kohë të gjatë e kaq e vërtetë qi, në lagjen Ballabane, përball shtëpisë të Shan Shantos, ushtria turke ka qindruet me çadra deri atë ditë qi Turkija ka dalë krejtësisht prej Shkodret.

Unë qi shkrova këtë episod, nuk kqyra datat kronologjike, pse puna e dhunimit të Xhamisë, ka ndodhë disa vjetë para termekut qi ka ra në vjetin 1905. Gjithashtu edhe jetën e fëmijërisë teme, ishte dashtë qi ta kishe ditue ma përpara, por tue kenë se unë e fillova autobiografinë teme tue fillue nga vjeti 1902,

THE SARE TURISTIKE TË DUKAGJINIT

- Blini i Gurit të Lekës -

Blini i Gurit të Lekës, ndodhet në vend-
pjekjen e Lumit të Shalës me Liqenin e Ko-
manit, në prehrin e Komlemit, karshi Mollës
së Shoshit me plot histori, histori e varrosur
aty e cila lidhet me princin tonë Lekë Du-
kagjini. Prof. Ahmet Osja, i cili ka jetuar e
punuar për vite me rradhë në këtë zonë
thotë që Lekë Dukagjini vitet e fundit të
jetës i kaloi në këtë vend, përballë i mbro-
jtur nga humnerat shkëmbore që zbresin
thikë deri në Dri dhe nga pas shpine nga
mbrojtja besnike e banorëve të Dukagjinit.
Emrin "Komlem" thuhet se e mori kur
rrethimi i ushtrisë turke zgjati aq shumë sa
atje lartë midis atyre shkëmbinjëve lindën
72 djem. Përballë Komlemit, nga ana tjetër
e lumit, ndodhet një shkëmb i cili mban
emrin "Curri i Haxhi Begut" nga ku ushtria
turke thonë që gjuante me top malësoret e
ngujuar aty në Komlem bashke me princin.
Një natë Leka ju thote ushtarëve, që të hed-
hin vozgat me raki në shkëmb duke ju vënë
flakën. Vargu i flakës zgjatej deri poshtë
në Dri dhe turqit e lëshuan rrethimin duke
menduar se ishte barut dhe se këta pas-
kan aq shumë barut sa edhe ta djegun në
humnerë. Veëm kur arrin aty te Guri, e
kupton se pse i thonë Guri i Lekës, sepse
pasi je ngjitur mbi të dhe ke hedhur vesh-
trimin rreth e rrotull, kupton se ai është një
vend strategjik vrojtimi. Nga maja e këtij
guri, mund të "krehësh" të gjithë zonën
në një hark prej rreth 300 grade. Pra Leka

nga ky gur ka pikasur çdo levizje të armi-
kut dhe kujdo që ka tentuar ti afrohet. Disa
qindra metra afër Gurit, ndodhet Shpella e
Lekës, një shpellë me një hyrje jo shumë të
madhe por që pas rreth 20 m zmadhohet
dhe që vazhdon pikjatë poshtë në drejtim
të lumit. Sipas gojdhënave thuhet se Leka
kishte lënë amanet që pas vdekjes trupi i
tij të hidhej në këtë shpellë, në mënyre
që të mos i gjendej nga pushtuesit turq,
kjo duke patur edhe parasysh se çfarë ata
bënë me varrin dhe eshtrat e Prijësit Gjergj
Kastrioti-Skënderbeu. Historia jonë, por as
arkivat e ndryshme nuk dokumentojnë për
vendin ku Lekë Dukagjini kaloi vitet e fundit
të jetës, për kohën e vdekjes apo për vend-
varrimin e tij. Duke u mbështetur dhe të
gojdhënat thuhet, se Leka bëri terheqjen e
fundit prej Kalasë së Lekës që ndodhet në
Rajë, përforcohet hipoteza se ky vend, pra
Blini, është posaçërisht vendi ku Leka kaloi
vitet e fundit të jetës së tij.

Gjithsesi për të vertetur dhe hedhur
dritë mbi vendin vdekjes së Lekës duhet
shumë punë, por për të vertetur se ku
lindi Prof Zef Gjeta është shumë e thjeshtë
sepse Zefi lindi bash këtu, në Blini të Gurit
të Lekës. Të vizitosh këtë vend në shoqërinë
e Prof Zefit, është një kënaqësi e veçantë
pasi ai pa e fshehur nostalgjinë që ka, flet
me shumë pasion për këtë vend dhe për
historinë që lidhet me të. Udhëtimi drejt
Blinit paraqet surpriza të pafundme pasi
ka atraksione të shumta turistike përveç
atyre që paraqet liqeni si lumi me troftën
pikaloshe, shpend dhe kafshë të ndryshme,
nga çdo anë mund të shikosh dhritë e egra
nëse atje kalohet pa zhurmë. Komlemi, Bira
e Topit, Guri i Lekës, Shpella e Lekës, Ball-
koni i Dhive të Egra, Ujvara e Mullinit dhe

pafundësisht drethëza, mjedrra, manafë-
ra, hudra të egra etj etj. Petriti dhe Paulin
Qeta, janë dy vëllezërit që i dhanë jetë këtij
vend, nipat e Ndokë Micit, pra kushërinjt e
parë të Prof. Zef Gjeta, të cilet kanë ndër-
tur Hotel-Bar-Restorant Blini, në breg të lu-
mit, një ndertim i bukur duke ruajtur edhe
traditën e ndertimit me gur e dru.

Porsa mbërrin aty, të kap syri disa varka
të vogla, të përshtatura me motor skafi dhe
në brendësi të tyre të improvizuara disa kar-
rige, për ta bërë udhëtimin më komod. Për
një moment të duken si gondolat e Vene-
cias. Vetëm 2 orë e 30 minuta larg Tiranës,
në rrethinat e Shkodrës ndodhet liqeni i Ko-
manit, padyshim një nga vendet më të vir-
gjëra dhe më të bukura që ka vendi ynë. Dhe
për mua ishte një destinacion i padëgjuar,
por pas vizitës u kthye në pikën më të bukur
turistike që kam vizituar ndonjëherë.

Pasi hipën në varkat të gjendura në mo-
lin e liqenit, vazhdon udhëtimin për plot 1
orë e 30 minuta, me një pamje magjepsëse.
Me male të larta e të dendura me pisha e
shkurra, diku shikon ndonjë shtëpi të ndër-
tur me dru apo gurë gati për t'u rrënuar,
e diku më tutje të kap syri disa shpella të
gërmuara, sikur i ka bërë dora e njeriut.
Por padyshim gjithçka është natyrale dhe
shumë pak dora shkatërrimtare e njeriut ka
ndërhur.

Gjatë kësaj kohe mund të kridhesh në
liqen, e të shijosh ujën e pastër e të ngrohtë.
Ka raste kur "skafistët" bëjnë gara me njëri
tjetrin se kush do të ecë më shpejt, e kjo
e shton më shumë adrenalinën e push-
uesëve, të cilët brohorasin për të qenë para
"konkurrentëve".

Por gjithë magjia e udhëtimit fillon në
lumin e Shalës. Ajo mrekuili e ka marrë em-

rin "Parajsa". Do t'ju duket ekzagjerim ky
epitet, por më besoni, e meriton.

Sapo varka merr kthesën, të shfaqet
një pamje, e thënë thjesht përrallore. Një
ujë i kristaltë, ku arrin të numërosh gurët
nën ujë, disa varka të parkuara dhe njerëz
rrëzëlliten buzë bregut të lumit duke marrë
rreze. Një urë druri e improvizuar, ku pady-
shim kush ka shkuar nuk ka lënë pa shkre-
pur një foto. Pak më lartë një lokal prap
prej druri, që të servir pamjen e "ishullit"
në pëllëmbë të dorës.

Ndërsa qëndrimi në lumin e Shalës zg-
jat rreth tri orë, është e kotë po nuk u lave
një herë në lumë. Dhe pse uji është i ftohtë
brisk, kur shikon që është qelibar, nuk
reziston dot. Ajo që të shijon më shumë
është buka e marrë me vete nga shtëpia.
Nuk është turp jo. Kur shikon që të gjithë
janë aq modest, me një peshqir të shtruar
në gurët buzë lumit dhe pse nuk qëndron
aspak rehat, ti nuk bën naze. Nuk ke kohë
të kërkosh luks, por do vetëm që ato pak
orë të kalojnë sa më ngadalë. Fatmirësisht,
antemat e kompanive celulare nuk kanë
mbërritur në "Parajsë", duke të shkëputur
një herë e mirë nga mania "teknologji".

Me siguri të gjithë i premtojnë vetes se
duhet të vijin dhe një herë, e të sjellin me
vete disa miq apo familjarë, që padyshim,
do ta adhurojnë këtë vend.

Turistët kryesisht janë të huaj, por ka
dhe shumë shqiptarë. Muajt më të reko-
manduar për të vizituar liqenin e Komanit,
janë korriku dhe gushti.

Ju, që do të udhëtoni vetem uroj ta kaloni
bukur!

Ju, që keni mirësinë të më ftoni edhe
mua, do ishte edhe më bukur!

Përgatiti, Lulash Brigja

mu desht doemosdò me lanë
për ma vonë ato ngjarje qi kishin
ndodhë përpara. Por tash qi pashë
gabimin tem, po rreshtoj jetën e fëminisë
teme, tue fillue prej moshës tri vjeç e deri
në ditë të sodit.

Atë vjetë qi linda unë, bash ndër ato ditë
të vjeshtës, pati vershue lumi Kir me furi
(lum ky qi buron në fshatin Kir të Dukagjinit)
zbret në Shkodër, kalon kah Ura e Mesit, në
Bardhaj, kalon mbrapa vorreve katolike, u
tha shokëve të vet: ndigjoni burra, per me
çue qellimin tonë në vend, duhet qi na të
sulmojmë edhe kazemat e ushtrisë Turke
qi aso kohe ishin ku janë ato të sodshmet
(karshi spitalit civil). Zani i Mirashit, i bur-
rnoi malësorët me mësyje edhe një herë
me qellim qi mbas shprazjes së pushkëve,
ushtarët do t'u detyrojshin me dalë jashtë
në dritë ndersa këta (malcorët) tue kenë në
arrësinë, banë një masakrim mbi ushtarët
e shkretë qi nuk kishin kurrnji faj në këtë
pikë.

Kështu pra, mendihmen e territ, mal-
corët iken tue marrë me vedi shokun e
plagosun e thonë se diq rrugës e këta, të
kënaqun per trimninë e bame kundra qe-
verisë Turke, shkuen të gjithë në Shalë nder
shpijat e tyne pa u hi ferrë në kambë.

Ma vonë, qeverija u kujtue se sa shtrejt
i kushtoi vrasja e atyne dy malcorëve, por
Turkija nuk ia vuni veshin aq shum kësaj
ngjarje e me kaq i dha fund. Por edhe me
pasë dashtë me ndjekë fajtorët, a do të
kishte kenë e mundun me hi ushtria Turke
në Shalë në ato kohna? jo kurr pse ata në
vendin e tyne u mbrojshin aq mirë si në
kohën e feudalizmit, e në këtë mënyrë, qe-
verisë do t'i kishte kushtue viktima tjera të
shumta, prandaj nuk e çoi ma gjatë e me
kaq mbaroi episodi i Shaljanëve.

Mbas këtij fillon edhe një tjetër, qi ma

pati diftue baba jem para se të vdiste.

Në Shkoder, burrat e kapodaitë nuk
mungojshin. Nji nder ta ka kenë edhe Beqo
Qoshja, njeri i permendun per burrni e
trimni qi të gjithë ia lëshojshin rrugen si me
kanë Don Rodrigo (personazh kryesor në
romanin – I promessi Sposi – të Alessandro
Manzoni) e ia kishin frigen shum se nuk pri-
tonte me qitë pushkë per punë të kotme.

Beqo Qoshja ishte ba shum i paduruesh-
em e pengesa të mëdha i qiste popullit e
qeverisë e ma teper Legatave të hueja qi
raportojshin per sjelljen e pa bukur të tijen
në qytet. Ky jo se i bante keq kuj, por në çdo
vend o pijetore qi shkonte, qiste pushkë
perpjete si shej burrnijet aq sa njerëzve të
qeverisë nuk u bante pershtypje pse ishin
të bindun se ai vetë ishte qi shprazte kubu-
ren simbas qefit të tij.

Por ma në fund ky e kishte teprue me
episodet e tij në mënyrë qi edhe qeverija
ishte meritë prej tij e donte me e shporrë
nji herë pergjithmonë Beqo Qoshen. Për
këtë punë kje ngarkue Ndue Pepa, zaptije
(polic) në sherbim të qeverisë. Ky bashkë
me shokë shkoi e i doli para te vijat e mul-
linit në lagjen Rus i Madh (rus maxhar) e aty
do të pritshin rasen kur beqo-ja të kthente
në shpi e kështu me e vra. Megjithëse këtij
i kishte shkue fjala në vesh për këtë dredhi
qi do t'i bajshin, por ai nuk e mori në dorë
e vazhdoi rrugen kah shpija. Kur Ndue Pepa
e pau prej së largut i tha: Beqo Qoshja,
dorzoju me ndër, por ai si kapodai qi ishte,
nuk u tund prej atyne fjalëve; nderkaq nji
batore pushkësh u shprazne tue rrëxue për
dhë Beqon. Ky tue e pa vedin ngusht e të
mbuluem me gjak, u mundue me mbyllë
varrët (plagët) e veta me fistan (fund pel-
hure veshje e burrave myslimanë të qytetit)
e kështu desht me e provue vedin tue u çue
në kambë per me iu pergjegjë atyne disa

herë me pushkë; por qindresa kje e kotë
pse nji batore tjetër pushkësh ra në drejtim
të tij e ra dekun për dhë. Kështu pra mbaroi
tragjikisht edhe Beqo Qoshja me trimënitë
e veta.

Ndikimi i kapitacioneve në Shqypni

Turkija kishte kenë e shterngueme prej
potencave (fuqive) të hueja, me njoftë (re-
spektue) kapitacionet në vend të saj (në
Turki). Kjo gja kje ajo qi i bani me humbë
autoritetin Turkisë, pse të huejtë, me këtë
rasë, perfitojshin shum tue veprue lirisht
në vendin e saj (Turki) pa muejtë me i
thanë kush gja; me pak fjalë me luejtë në
kurriz të saj tue gëzue privilegje të mëdha.
Per shembull, nji i huej mujte me veprue
keq, edhe në rasë qi ai bante ndonji krim,
autoritetet Turke nuk kishin të drejt me e
arrestue por me ia dorëzue konsullit të vet
simbas nenshtetësisë qi ai kishte.

Vetëm ky kishte të drejt me e arrestue e
me e nisë në vend të vet simbas raportit të
lëshuem nga ana e legatës ku kishte ndollë
ngjarje e kështu në shtetin e vet, fajtori u
dënonte. Pra në këtë mënyrë veproshin
të huejt në Turki pa farë friget. Edhe në
Shqypni (qi u konsideronte Turki) më bjen
nder mendë mirë, kur autoritetet Turke
dojshin me arrestue kend, megjithëse ishte
shqyptar, por kishte nenshtetësi të huej, ky
i mbyllte deren në fytyrë pa muejtë me hy
kush mbrendë prej tyne, por i lejshin jashtë
derës urdhnin e arrestimit të cilin fëmija e
shkyejshin. Të njajten gja më ndolli me pa
per arrestimin e Luigi Gurakuqit ku nji polic
shkoi me shokë per me u arrestue; mirëpo
i ati tij Pjetri, punonte në legaten italiane e
i pengonte me hy mbrendë, atëherë i lanë
jashtë derës urdhnin e arrestimit, por e
ama Lezja e shkjeu copë copë e ata u nisën
me krye për dhë pa muejtë me krye qelli-
min e vet.

Influencen ma të madhe në Shkoder
e kishte Austria. Kjo kishte marëdhanje
të ngushta me autoritetet turke edhe me
myslimanët e vendit qi ishin me randësi
të madhe nder punët e shtetit. Këtë fuqi e
mori Austria dhe e mbajti deri në fund të
luftës parë botnore njatë herë kur kje zhg-
atrimi i saj.

Në ato kohna, Austria e Italia kishin
edhe postat e veta e pullat e tyne qi funk-
sionojshin rregullisht me shpërdasit e tyne.
Ndrekë Demiri per Austrinë e Filip Kraja per
posten italiane. Kështu, nepermet të kë-
tyne postave, shqyptarët e Rilindjes krye-
jshin ma së mirit sekretet e veta. Gazeta
"Dielli" e Faik Konicës, vinte nga Amerika
(Boston U.S.A.), rivista Albania, vinte nga
Londra, libra shqyp nga Sofia e Bukureshti
ku ishin perpjekjet e shqyptarëve qi puno-
jshin për lirinë tonë; prandaj Bullgaria u
dha shqyptarëve atje lehtësina të mëdha
në Sofje, veçanërisht nga ana e shtypit.

Por mbasi qi këto janë pika qi nuk më ta-
kojnë mue me i shkruje, do të i a la ndonji
historianit me dhanë skjarime mbi Rilind-
jen tonë; megjithëse edhe unë jam i asaj
kohe ku kam dhanë edhe kontributin tem
jashtë e mbrendë Shqypnijet, por mbasi
nuk janë gjana me shkrim, sigurisht qi sot
kanë ra poshtë të gjitha.

Postjerët qi permenda ma nalt, posten
e vet e kishin të sigurueme pse autoritetet
nuk mujshin me ia prekë deri sa t'a dorëzo-
jshin në dorë, por kur e merrshe në dorën
tande e kur ajo ishte e dyshimtë per qe-
verinë e Turkut, ata ta hiqshin prej doret e
menjherë të arrestojshin.

Përgatiti për botim Lulash Brigja

Motrat e rregullit Françeskan 25 vite bashkëjetesë dhe kontribut kulturor në Bajzë të Kastratit

Qysh me rënjen e sistemit ateist të komunizmit në vitet 90, banorët e Kastratit, por jo vetëm, e ndien veten të çliruar dhe me të drejta të plota njerzore, morale e jetike, për të vepruar e menduar të lirë në fe, besim e lutje, të drejta këto të privuara nga sistemi ateist për më shumë se 25 vite. Mbyllja e kishave në vitin 1967 dhe rrenimi i tyre nga ateistet e sëmurë me lavazh mental - ideologjik, bëri që besimi të tkurret vetëm në brendësi të mëndjeve dhe zemrave të besimtarëve katolik, por jo vetëm. Të detyruar nga ajo disiplinë e hekurt që synonte ta çrrënjoste Zotin dhe besimin nga memorja njerzore, ku nuk mungoi as dhuna dhe lufta ideologjike, të cilën fare mirë mund ta krahasojmë me luftën ikonoklaste mesjetare, arriti ta kthente besimin në një makth dhe frikë për të gjithë besimtarët. Rënja e sistemit monoteist - totalitar dhe lindja e sistemit pluralist - demokratik bëri që era e lirise te ndihet kudo dhe në çdo gjë, sidomos në fe e besim, ndaj që në vitet 90-91 banorët e Bajzës e më gjërë bashkohen në lutje pranë rrënojave të kishës së vjetër, kryesisht natën, nën dritën e qirijve e me uratë në duar, luteshin për orë të tëra si një familje e vetme.

Organizimi kishtarë, aso kohe

në fillesat e veta, duke pare gjithë këtë etje për besim tek ky komunitet, dergoi misionaret e vet prane kësaj bashkësie, ku përveç fretënve, në kbashkësinë e Bajzës vijne e vendosen ne nje godinë ë vjeter (fermentimi) fare pranë rrënojave të kishës një familje misionarësh të Rregullit Françeskan. Ardhja e motrave në vitin 1992, shënon fillësën e një bashkëjetese fetare e sociale të kësaj familje të re, me familjen e madhe të Kastratit, e cila

me 9 korrik 2017 mbushi plot 25 vite. Në këtë pervjetor u organizua një festë jubilare, me një koncert të pergaditur nga të rijnt dhe të rejt e famullisë, e shoqeruar me një meshë soleme të drejtuar nga monsinjori Anxhelo Masafra, në të cilën u bënë dhe pershendetjet e rastit nga eproret e këtij Rregulli, si dhe një pritje koktei per të gjithë besimtarët, të shtruar nga motrat e kësaj familjeje.

Kontributi i këtyre misionareve ka luajtur një rol të madh në mirëedukimin dhe civilizimin e këtyre banorëve, ku një meritë të veçantë kanë dy motrat më të vjetra, Motër Pia dhe Motër Anezina, të cilat kanë rreth dy dekada që kanë ardhur në këtë qendër banimi dhe kanë kontribuar pa shkeputje me një devocion shumë të lartë. Tashme ato gëzojnë imunitet absolut në respektin dhe mirënjohjen e të gjitha familjeve kastratase e më gjërë. Roli i tyre ishte dhe vazdon të jetë një dashni e pakushtëzuar fetare e humane. Ato u asimiluan në jetesën e përditshme të kësaj bashkësie, duke kontribuar si motra të vereta në hallet, problemet dhe vështirësitë e të gjithëve, ku një vëmendje të veçantë kanë të varfërit me nevojat e tyre. Një kontribut teje të madh për këtë

bashkësi ka dhënë Motër Enca me misionin e saj human "për një shëndet të mirë dhe falas" për të gjithë bashkësinë pa dallim feje, duke ju siguruar medikamentet deri edhe nderhyrje kirurgjikale, vizita dhe sherbime ekstra pacienteve të sëmurë, gjithçka falas.

Depertimi i këtyre motrave në familjet e famullisë ka qene i drejt për drejtë pasi prej afro dy dekadash, themeluan kopshtin "Nëna e Krishtit Fëmi" e bazuar në një kurrikul të avancuar evropiane. Famullia e Bajzes ka pasur një vëmendje shumë të veçante nga Vatikani rreth viteve 2000 - 2005, për nga numri i lartë i besimtareve. U propozu që të kthehet në një qendër dioqezjane, ku të perfshiheshin Pult - Malësi e Madhe. Atributi kryesor për këtë përpjekje i takon Pater Prel Gjurashaj aso kohe Administrator Apostolik, i cili në bashkëpunim me motrat e kësaj familje dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në faljen e gjaqeve dhe vendosjen e paqes në famulli, ku e paharruar në memorje e besimtarëve mbetet falja e gjakut në kishë ditën e Krishtëlindjeve 2002.

25 vite kontribut do donin mijëra fjalë falënderimi për këto misionare, por po e mbyll me fjalët e famullitarit aktual Pater Aleksander Tanushit, në fjalën përshendetëse: "U SHTOFSHI E U SHËJNTËROFSHI!".

Përgatiti Rita Shkurtaç



Revolta e Qafë Barit, përballja e Dukagjinit me ç'nderimin komunist



Prof. Dr. Lush SUSAJ

At Anton Harapi ka thënë (20 Shkurt, 1946): "Në rrudhat e tokës gjënden të ruejtuna gjaku, eshtrat, amanetet, lotët e nanave, e vërteta. Në gjoksin e historisë shndrisin jeta dhe vepra e prelatve brilantë të Kombit Shqiptar. A s'e dini se çdo ndërtesë i vihen themelet në dhe? Edhe pse në varr, hijshëm duhet të jemi gurët e themelit të njasaj binaje të cilën sot e quajm Shqipni". Ndërsa, Orhan Pamuk (Nobël, 2006), në vepren me titull "Unë Jam e Kuqja", ka theksuar se nuk mund

të ketë qetësi as zhvillim pa bërë drejtësi për viktimat dhe krimet e kryera

Shkaqet e revoltës së Qafë Barit ishin fyerjet, keqtrajtimet, ç'nderimi dhe rrahja publike e djemëve dhe burrave të burgosur. Kjo sjellje ka qënë në kundërshtim edhe me vetë ligjet e shkruara të komunizmit dhe me moralin dhe traditën shqiptare, ku burrat nuk rrihen me shpulla as me dru zjarri.

Sipas dëshmimeve të shkruara dhe të treguara nga At Zef Pllumi, në kampet dhe në burgjet e diktaturës komuniste, ka patur një qëndresë dhe rezistencë të vazhdueshme nga të gjitha krahinat dhe shtresat e shoqërisë. Në kuadrin e kësaj qëndrese, bie në sy rezistenca e fortë, fisnike dhe dinjitoze e popullsisë katolike dhe klerit katolik në veçanti.

Në lidhje me vrasjet, dhunën dhe persekutimin ndaj malsorëve të Shqipërisë, dhe katolikëve në veçanti, Enver Hoxha dhe krerët e lartë të shtetit komunist, janë këshilluar me dy nga udhëheqësit më të njohur dhe më antishqiptarë të periudhës komuniste.

I pari ka qënë Tito ai që e ka këshilluar Enverin që të heq qafe sa më parë klerin katolik. Bedri Spahiu i ka pohue ne qelin e burgut Don Simon Jubanit se: "J. B.

Tito i ka thanë E. Hoxhës, nëse dëshironi të siguronit pushtetin komunist, atëhere vritni dhe burgosni klerikët katolik". Dhe diktatori pa e menduar më gjatë qëllimin antishqiptarë të tyre, nuk ngurroi të zbatonte këshillën e Titos që u ba frymëzim dhe shkak për turturat, burgosjet dhe pushkatimet e klerit katolik.

I dyti ka qënë Stalini që e ka këshilluar Enverin që të ndërtoj një shtet dhe administratë politike pa katolikë ose me sa më pak prej tyre, duke i mbajtur larg pushtetit dhe duke i angazhuar në punë sa më të rendomta.

Këto këshilla, janë bërë burimi i qindra e mijëra pushimeve nga puna, i dëbimeve nga vendi, i arrestimeve, internimeve, denimeve dhe pushkatimeve të katolikëve të pafajshëm.

Këtu e ka zanafillën edhe mungesa 105 vjeçare e përfaqësimit politik dhe modeli i diskreditimit të katolikëve përmes përfaqësimit të tyre me njerëzit më të ulët të krahinave të tyre. Kjo dukuri ka shkelqyer gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist, ndërsa bëri bujë të madhe në vitin 2013 kur në Parlamentin Shqiptarë, shkuan vetëm katolikët që kishin probleme të rënda me drejtësinë dhe me sjelljen qytetare.

Nga këtu është ushqyer edhe shpëllimi i shpejtë i fshatrave dhe krahinave katolike të Shqipërisë të lëna për një kohë shumë të gjatë në kushtet e një mizerje mesjetare, pa infrastrukturë, pa investime sociale, pa rend, pa shkolla, pa mjekësi dhe pa siguri dhe administratë publike.

Gjendja e të burgosurve në Qafë Bari ka qënë shumë e rëndë, përveç kushteve të rënda të punës dhe kequshqyerjes, të burgosurit atje janë përballur edhe me dhunën dhe barbarinë ç'njerëzore.

Incidenti i dhunës është sajuar në mëngjesin e datës 22 Maj 1984, kohë kur ndërrohej turni i tretë me turnin e parë të punës. Në grupin e atyre që përfunduan turnin e tretë të asaj nate ishte Ndue Pisha (nga Dukagjini) i cili nuk e kishte realizuar normën. Sipas rregullit, ky duhet të rikthehej në galeri pa pushuar, madje edhe pa konsumuar as ushqimin e mëngjesit.

Policet e shërbimit kanë urdhëruar rikthimin e Ndue Pishës në galeri, Sokol Zef Sokoli (djali i vetëm i Zef Bajramit nga Palçi i Merturit), dhe Tom Ndoja (nga Dukagjini), i janë lutur me përlulesi komandantit që Ndue Pisha të mos dhunohej dhe të mos kthehej në galeri pasi mosplotësimi

i normës nuk ishte faji i tijë dhe se norma do të realizohej në ditët në vazhdim. Kësaj kerkese njerëzore, komandanti i është përgjigjur me arrogancë duke shtruar alternativën, o në galeri ose do të fillonte dajak.

Ky fakt dëshmohej edhe në dokumentin e datës 27 Maj 1984, me titull: "Mbi ngjarjen e ndodhur në datën 22 maj 1984 në regjimin e të dënuarve të repartit 311 Qafë Bari".

Sipas versionit të këtij dokumenti zyrtarë (si çdo dokument tjetër përmban edhe doza të larta të mashtrimit komunist për të shfajësuar dhunuesit e për të ngarkuar me fajë të pabëra të vrarët e të dhunuarit), strukturat e ish sigurimit dhe policisë sekrete, kanë qënë në dijeni dhe në kontakt të vazhdueshëm me atë që po ndodhte në burgun e Qafës së Barit. Në raportin e hartuar 5 ditë pas ngjarjes, sipas modelit të fajësimit maksimal të burgosurve, janë përshkruar datat dhe rrethanat e fillimit dhe të vazhimit të revoltës.

Në dokument thuhet se në orën 07. 30 të datës 22. 05. 1984, është njoftuar se dy të burgosurit e turnit të tretë, Ndue Pisha dhe Ndrej Nikolla, nuk kishin realizuar normën në galeri dhe sipas rregullores së kampit duhej të riktheheshin me turnin në vijim.

Kundërshtimi i prerë i dy të burgosurve të tjerë, Sokol Sokoli e Sokol Progni, për t'i kthyer mbrapshtë dy bashkëvuajtësit e tyre u bë shkak i përplasjes së pazakontë.

Ndërhyrja e forcave të policisë për të çuar në dhomat e izolimit të pabindurit, ndezi protestën e pjesës tjetër. Të dënuarit Sokol Sokoli, Sokol Progni, Tom Ndoja, Martin Leka, Dedë Nimani, Bajram Vuthaj, Ndue Kola, Haxhi Baxhinovsi, Lush Bushgjoka e Kostandin Gjordeni, aty për aty u vendosen në pozicione mbrojtëse dhe u bënë thirrje policëve për të lëshuar shokët e tyre.

Komandanti dhe policët e burgut e dinin shumë mirë që rrahja publike e atyre djemëve dhe burrave do të revoltonte të afërmit dhe shokët e tyre të burgut. Policët ishin të sigurtë për reagimin e Sokolit, Tomës dhe të çdo shqiptari të lindur, të rritur dhe të edukuar në familjet tradicionale e nacionaliste të vendit. Policët dhe drejtuesit e kampit e dinin faktin që malsorët qëndrojnë dhe e

kanë për nder të vdesin së bashku përballë së keqës.

Ata e dinin që malsorët e urrejnë dhunën dhe fyerjen publike, madje e përçmojnë dhe e kundërshtojnë edhe dhunën e ushtruar ndajë kafshëve.

Në këtë mënyrë, provokimi dhe skenari i kësaj gjakderdhje që shumë i lehtë për t'u realizuar nga organët dhe personazhet e diktaturës.

Sokol Sokoli i është ofruar dhe i është lutur përseri komandantit dhe policëve që të mos i rrahin e të mos i ç'nderojnë djemtë në sy të burgosurve të tjerë. Lutjet ranë në vesh të shurdhër, policët vazhduan me skenarin e shefave të tyre duke e shtuar shantazhin, kërcenimet dhe dhunën fizike ndajë të burgosurve.

Në këto kushte, të burgosurit nga Dukagjini dhe Nikaj-Mërturi e kanë marrë në mbrotje Ndue Pishën, duke e shpetuar përkohësisht nga rrahja publike.

Oficeri i rojes që ndiqte nga afër të gjithë skenarin dhe reagimet e të burgosurve, ka urdhëruar policët që të rrethonin fjetorën, ndërsa të burgosurit i ka urdhëruar që të futeshin në mensë.

Të burgosurit e terrorizuar, të fyer, të pa ushqyer dhe pa asnjë mundësi mbrojtje, kanë zbatuar urdhërin dhe janë futur në mensë.

Oficeri i rojes ka shkuar në mensë, ka hipur mbi një stol dhe ka urdhëruar: "kush degjon emrin të dalë jashtë, ndryshe e dini mirë se ç'farë ju pret".

Me arrogancë, me urrejtje dhe me nervozizëm të lartë, oficeri ka urdhëruar më zë të lartë: "Ndue Pisha, të dalë jashtë".

Pas këtij urdhëri të prerë, Ndue është përshëndetur me shokët dhe është nisë për të dalë nga dera. Menjëherë pas emrit të Ndout, janë thirrur edhe emrat e Kostandin Gjordenit dhe atyre që në kohën e ndërrimit të turneve, prapësuan Ndoun për të mos u rifutur në galeri.

Të burgosurit shikonin se si shokët e tyre, sapo dilnin nga dera e mensës, i prangosnin menjëherë dhe i qëllonin pa mëshirë me shkelma, me shpulla e me grushta.

Britmat dhe ulurimat e të burgosurve që rriheshin e gjymtoheshin në dhomat e izolimit u bënë të padurueshme, ato dëgjoheshin në mensë dhe në të katër anët e kampit.

Kjo dhunë ç'njerëzore dhe gjymtimet

e të burgosurve përmes goditjeve dru zjarri, nuk janë pasqyruar në asnjë raport, nuk janë hetuar nga askush edhe pse shumica e autorëve (dhunuesve) dhe të burgosurve (viktimat), janë akoma të gjallë e me kujtesë normale.

Në këtë situatë të mbushur me dhimbje, provokim dhe fyerje, të burgosurit e kanë humbur durimin, dhe janë vërsulur të revoltuar për të dalë jashtë, në mbrotje të shokëve të tyre.

Kështu ka filluar kacafytja ndërmjet të burgosurve të "armatosur" me tulla dhe gurë nga njëra anë dhe policëve të armatosur me armë dhe plumba policani nga ana tjetër.

Pavarësisht nga përforcimet që erdhen menjëherë, të burgosurit kanë qëndruar heroikisht duke sfiduar dhe sprapsur dhunën e shfrenuar të policisë.

Në këto rrethana, oficeri i rojes ka filluar të gjuaj me kallashnikov. Plumbat e parë kanë goditur Kosta Gjordenin në shpatull i cili është mjakuar brenda kampit.

Situata është përkeqësuar edhe më shumë pas mbërritjes të grupit të oficerëve nga Ministria e Brendshme e që fillimisht kanë fluturuar me helikopter sipër kampit e më pas janë ulur mbi një kodër jashtë kampit.

Njëri nga oficerët që kishte njohje dhe lidhje gjaku me ish të burgosurit nga Nikaj-Merturi dhe Dukagjini (e që ishte sjellur aty kastin për ta ngatërruar, denigruar e djegur), komunikoi me komandantin dhe ju komunikoj të burgosurve 5 minutat e kohës që u dha komandanti për t'u dorëzuar, në të kundërt do të hapej zjarr e do të vriteshin të gjithë.

Në këtë moment, 12 të penalizuarit kanë marrë vendimin e tyre të padiskutueshëm dhe u janë drejtuar shokëve me fjalët: "Po shkojmë që të mos vritemi të gjithë".

I pari që ka shkuar të dorëzohet ka qënë Sokol Sokoli, pas tij Tom Ndoja dhe një e nga një dhjetë të tjerët. Rregjimi komunist në Shqipëri, duhet të trajtohet dhe të kujtohet si ligësia, pabesia dhe fliqësia më e madhe e kësaj bote. Ndërsa njerëzit që ushtruan pa mëshirë e pa norma zakonore dhunën dhe terrorin e këtij sistemi, duhet të kujtohen dhe të trajtohen si antishqiptarë dhe antihumanë.

Në Shqipëri, në shkollën e lartë të

Ministrisë së Brendshme në Tiranë, është bërë mësim i rregullt mbi turturat më çnjerëzore që mund të ketë parë dhe rrëgjistruar shkenca dhe memorja e kësaj bote. Ish të burgosurit e diktaturës komuniste tregojnë se si, teknikët e besuar nga komanda, ishin shumë të përpiktë në atë që bënin, jo vetëm nga përkushtimi, por dhe nga teknikat e përdorura. Të rrihnin mirë e mirë me ç'tu ndodhej dhe nuk të shqiteshin deri sa të mbeteshe pandjenja. Kur dilje nga dhomat e turturës komuniste, mund të ecje vetëm këmbë e duar ose i mbështetur pas murit. Nuk qëllonte kurrë që të futeshe atje dhe të dilje me këmbët e tua.

Dhuna e përdorur në Qafë Bari, për nga perversiteti dhe monstruozeiteti ka tejkaluar çdo limit, eksperiment dhe model turture.

Këtë fakt e ka dëshmuar ish i burgosur i kampit sipas të cilit: "Orët në dhomën teknike, siç quhej ndryshe njëra nga zyrat e komandës, ishin të tmerrshme tek Zoti. Në krye, si nga hera, qëndronte shefi i policisë së burgut, barbar e gjakësor si ai. Na urdhëroi fillimisht që të hiqnim peliçet. Pastaj u kujtua se duhej të hiqnim edhe çizmet, trikot dhe çorapet. Ashtu bëmë, as që mendohej një sjellje tjetër. Më tej na tha të uleshim në dysheme. Aty filloi dhe rrebeshi i goditjeve me shkelma e grushte deri sa përdoruesit e tyre u lodhën. Më pas rrëmbyen drutë e zjarrit që ishin aty pranë. Me to në dorë na goditën bam e bum në kokë, në krahë, në gjoks. Një terror i paparë, dhoma sa nuk shpërthente nga britmat dhe ulërimat. Muret dhe dyshemeja u mbuluan me gjak. Të gjithë kishim mbetur përtokë të mbuluar në gjak".

Në këto 27 vite, asnjëri nga këta dhunues dhe vrasës të pashpirtë nuk është hetuar dhe as denuar. Nuk ka vend as kohë për harresë, jeta dhe vepra e tyre meritojnë mirënjohjen dhe kujtesën e përgjeshme sepse edhe në varr (siç thoshte At Antoni), janë gurët e themelit të njasaj binaje, të cilën sot e quajm Shqipëri. Martirët e lirisë dhe të qëndresës, ishin, janë dhe do të mbetën nderi dhe krenaria e kësaj toke, ndajë duhen kujtuar me fjalë, me lule, me homazhe dhe me drejtësi.

NANËS TEME!

I shtrejtë asht emni nanë e them për çdo njeri, aq ma i fortë asht malli kur të len, e je në rini!

Gjithkush të njohu ty -Burrnore, të thanë Ky asht epiteti që njerëzit ty të dhanë!

Shane, emni yt një emën ndër ne i rrallë, Nanë e grue fisnike ishe dhe të kujtoj me mallë!

Këto vargje ty due me t'i kushtue, se as diktatura komuniste nuk të bani me u dorëzue!

Skaj më skaj Shqipërisë ti ke shetitë, dhe kjo jo për qejf por veç me ndjek fëmijët

Fytyra e jote e ambël përcillte mirësi! Kush të kërkoi ndihmë kurrë nuk je kursy!

I pari ishte besimi që ti kishe në Zotin gjithnjë tue u lutun e shkojshe ti motin!

Nder ke kenë, dhe gjithmonë je për ne, shpirti dritë të ban atje në qiell ku je!

E unë po lutem për ty, e ti lutu për ne!

BABËS TEM!

Baba jem nuk vdiq i ri por as i vjetër nuk ishte ai.

Shtatë vjeç më ka lanë por mend e mbaj, i hollë e i gjatë, plot hijeshi! Kur bahej festa ishte ai!

I pëlqente shumë me këndue, në male e në fusha kudo që ka shkue.

Ai kangën e kishte në gjak e qejf bante në çdo konak!

Ishte babë dhe njeri me vlera! Dhe mua emnin ma ngjiti Vera.

Erdhi sëmundja e filloi me u randue por ai nuk donte me u dorëzue . . .

-Vera, - më thirrte hajde me këndue! Miq e të afërm me më pa mue!

U krenonte baba jem: "Vera e babës, ka zanin tem"!

Edhe unë po me këtë za', "Pushosh në paqe"! i them pa pra' !

Vera Mici

VJOLA, NJË LULE QË NUK VYSHKET KURRË

- Vjoleta Zefi, pas 50 vitesh në skenë, sot "Mjeshtre e Madhe" -

Vjoleta Zefi, me një vokal dhe interpretim krejtësisht të veçantë, vazhdon të elektrizojë edhe sot e kësaj dite skenën e muzikës popullore qytetare shkodrane e në mënyrë të veçantë me zërin e saj vazhdon të zbukurojë oborret e lulëzuara ku ashtu siç ka emrin, gjenë edhe shoqet e veta që gjithmonë janë të freskëta e të lulëzuara.

E kanë quajtur "Mbretëresha e këngës shkodrane". Ajo lindi në Shkodër më 15.6.1960 dhe u ngjiti në skenë në një moshë feminare në mars të vitit 1968, ku e inkuadruar me trupen e Estradës Profesionale të Qytetit, mahniti publikun me zërin dhe talentin e saj të mrekullueshëm, duke interpretuar dy këngë, "Librazhdë im sa fort të dua", dhe "Hyjo-hyjo, kalë vrapo".

Që nga këto shfaqje ajo nuk u shkëput më nga skena. Sa mbaroj shkollën 8-vjeçare, për nevoja ekonomike u vendos në punë në Uzinën e Telave në Shkodër. Pa u rritur mirë tashmë ajo ishte bërë e njohur në të gjithë Shkodrën.

Formimi i plotë si këngëtare profesionale e këngës popullore u bë pranë Teatrit "Migjeni", në këtë institucion nga ku kanë dalë me dhjetra këngëtarë të famshëm.

Këtu pra ajo u inkuadrua me trupen profesionale të Estradës së Shkodrës, përkrah këngëtarëve të mëdhej Bik Ndoja dhe Shyqy Alushi, ku për një kohë të gjatë këndoi në trio, bashkëpunim që i solli një sukses të jahtëzakonshëm si në Shkodër ashtu edhe në turne jashtë shkodrës.

Dalja e saj gjithnjë përkrah dy kolosve të këngës Shkodrane, krijuan tek ajo vetëbesim për të kënduar në skenë por edhe përfitoi prej tyre shumë për këngën popullore shkodrane. Ajo pati fatin e madh, që në këtë moshë të njomë të kishte pranë vehtes këngëtarë, instrumentistë dhe humoristë ndër më të njohurit dhe më të aftët e artit skenik shkodran.

Në kohën që punonte në Uzinën e Telave, u njoh me parodistin dhe humoristin e mrekullueshëm Gjoshë Vasija, që në atë kohë drejtonte grupin artistik të kësaj ndërmarrjeje, humoristin tjetër dhe aktorin Mark Lëkunda, këngëtarët Bashkim Alibali dhe Eduard Jubani, me të cilët dha me dhjetra shfaqje dhe fitoi sa e sa çmime ndër festivale lokale dhe kombëtare.

Kur ishte ende 13 vjeçe, dhe pse në një moshë që askush s'e beson mori pjesë në Festivalin e 13-të Kombëtar të këngës në RTSH, me këngën "Tre brezat", e cila fitoi çmimin e tretë. I vetmi rast që në këtë moshë konkurron në festival, duke befasuar publikun e Tiranës me talentin dhe interpretimin e saj të sinqertë feminarë, të brishtë e të pasigurtë ende. Gazetat e kohës, filluan të shkruanin për këngëtarën e vogël shkodrane, për Shkodrën që të befasonte gjithnjë me talentet e veta në festivalet e RTSH.

Kështu Vjoleta vazhdoi të jetë pjesëmarrëse edhe në festivalin e 14-të, duke vijuar më pas me festivalin e 15-të me këngën "Dasëm në fshat", ku përsëri u vlerësua me çmimin e tretë dhe vazhdoi të jetë pjesëmarrëse edhe në festivalin e 18-të.

Vlerat e Vjoletes nuk qëndrojnë vetëm tek zëri, por edhe tek inteligjenca e saj për të plotësuar vetveten edhe me një repertor sa më të larmishëm e të dashur për publikun, me këngë shkodrane, të Shqipërisë së

Mesme, kosovare dhe të Jugut.

Vjoleta Zefi, u aktivizua në shumë drejtime, si këngëtare, si spikere dhe si aktore; kujtojmë këtu aktivizimin e saj tek drama "Përmytja e Madhe", ku ajo luajti përkrah aktorese së njohur të Teatrit "Migjeni", Vitorë Nino, dhe ku ajo në një aktivitet kombëtar të teatrove fitoi çmimin e parë si aktore amatore.

Natyra e saj e gëzuar, optimiste dhe plot



humor, përfaqësohet edhe në repertorin e zgjedhur për interpretim, këngë të gjalla dhe të gëzuara, plot dinamizëm të brendshëm e me shtrirje që i përgjigjen edhe natyrës së saj vokale, tematikë e larmishme, nga ato lirike dashurore, tek ato të trimërisë, të kurbetit, nga këngët e vjetra tek ato më të reja.

Talentin e saj ajo e ka demonstruar edhe në marrëdhënie me zërat e tjerë si në duete, ansamble vokale etj. Vjoleta që nga koha kur ka dalë për të parën herë në skenë, ka fituar respektin dhe dashurinë e spektatorit, i cili e ka duartrokitur dhe mirëpritur në çdo shfaqje. Këtë respekt e mirëpritje Vjoleta e ka patur jo vetëm në Shkodër, por në mbarë Shqipërinë, e në të gjitha skenat ku ka performuar jashtë shtetit.

Në të gjitha aktivitetet artistike kombëtare dhe ndërkombëtare Vjoleta është vlerësuar maksimalisht me diploma, çertifikata dhe medalje. Kështu vlerësohet me Çertifikatën e Çmimit të Parë, në konkursin e këngëtarëve dhe instrumentistëve solistë zhvilluar në Tiranë nga data 25 deri me 28 Mars 1971.

Festivali i Estradave i zhvilluar në Tiranë prej datës 21 korrik deri me 2 gusht 1971 e vlersoi punën e Vjoletes me Fletë Lavdërimi. Po kësaj kohe i takon edhe një Festival i Estradave që u zhvillua nga data 4 e deri me 6 gusht të vitit 1971, i cili e vlersoi me Medaljen e Shkallës së Parë, për interpretim shumë të mirë.

Në Festivalin kombëtar të Shtëpive të Kulturës, zhvilluar në vitin 1975, në Durrës, nderohet me Çmimin e Parë, si këngëtarja më e mirë.

Me 22 Shkurt 1975, i jepet Çertifikata dhe medalja me motivacionin "Për punë të

dalluar në përhapjen e kulturës në masat e gjëra".

Në vitin 1976 Vjoleta Zefi dekorohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullorë me urdherin "Naim Frashëri i klasit të dytë".

Vitet '80, kur Ansambli i Radio Shkodrës shkoi në Kosovë për të bërë një turne në qytetet kryesore, ajo këndoi me bashkëmbësit e saj. Ky kujtim do të mbetet i pashlyer në gjithë karrierën e saj artistike.



Në takimin ndërkombëtar të Turqisë (1981), Vjoleta u nderua nga juria me çmimin më të lartë duke i dhënë titullin "Mbretëresha e Festivalit". Vjoleten sukseset e ndoqën kudo. Në vitin 1993, kur shkoi në Amerikë, pritet shumë mirë, pastaj vijnë turnetë e tjera si: Zvicër 1994, Gjermani 1995, Mal të Zi 1996 e Maqedoni 1998.

Më 2 qershor 2005, nderohet nga Këshilli Bashkiak i qytetit të Shkodrës me titullin "Mirënjohja e qytetit", me motivacion: "Për meritën të veçantë në fushën e interpretimit të këngës popullore dhe për kontributin e madh të saj në këtë gjini".

Ka kënduar nën shoqërimin e brezave instrumentistë si: Abdullah Salabegu, Mark Kaftalli, Nazmi Lishi, Luan Barova etj.

Ka kënduar me orkestrat Simfonike të RTSH, RT Prishtinë, Shtëpisë së Kulturës Shkodër, Orkestrën e Ansambilit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore, Banden Frymore të Shkodrës, Orkestrinën e Estradës së Shkodrës, dhe shumë formacione të tjera orkestrale edhe jashtë vendit. Ka regjistruar 39 potpuri, prej të cilave 5 janë kolazhe dhe 20 janë duete dhe trio.

Ka bashkëpunuar me figura të tilla të artit shkodran si: Tish Daija, Tonin Harapi, Xhavit Ujkani, Nazmi Lishi, Luan Borova, Tonin Daija, Ilir Zoga e shumë të tjerë.

Në 7 albumet e saj ka 84 këngë të regjistruara, prej të cilave 61 janë shkodrane, 9 Shqipëri e Mesme dhe të tjerat nga krahina të ndryshme të Shqipërisë dhe të trojeve shqiptare jashtë atdheut.

Në Albumin "Hala jam", ka një bashkëpunim me këngëtarët Bik Ndoja e Shyqyri Alushi, si dhe një duet me këngëtarin Adnan Bala me këngën "Dukane".

Tek kënga "Edhe baba po m'bërtet", një

këngë e re e viteve '70, e krijuar enkas për dy tenorët e famshëm popullorë Bikun e Shyqin dhe vajzën e re, u krijua një trio e bukur që u realizua mjaft mirë nga të tre këngëtarët.

Në këtë shkrim ja vlen të evidentojmë disa nga interpretimet më brilante që Vjoleta ka në karrierën e saj, në veçanti në interpretimin e këngës shkodrane, duke përmendur këtu disa prej tyre: "Kndon bylbyli me t'madhin za", "Hala emrin s'ta kam zan", "Ashtë një djalë moj nanë", "Këngë për Mujo Ulqinakun", "O bylbyl, o i bukri shpendëve", "Shtëpia pastë gjithmon pranverë", "Erdhi pranvera", "Pse ti lule rrin e mshehun", "Këpucët me meste", "Djalë i dashur", etj., të cilat i gjejmë edhe në albumet e saj: "Tash du me fillu", "Pasha sytë e mi", "N'andërr më del", "Hala jam", "Merre një tub lule", "Ti je si një gonxhe" dhe "Shkodra ime".

Vjoleta Zefi është ndër ato këngëtare që me zërin e saj të ëmbël dhe me interpretimin e saj mjeshtëror ka mahnitur dhe ka bërë që spektatori të bëhet pjesë e këngës së saj duke e shoqëruar vazhdimisht me duartrokitje e duke kënduar bashkë me te. Skena dhe kënga popullore do ta dëshirojë gjithmonë zërin e ëmbël dhe interpretimin mjeshtëror të këngëtares Vjoleta Zefi".

Këngëtarja e mirënjohur Vjoleta Zefi jeton sot në qytetin e saj të lindjes në Shkodër me familjen e saj të mrekullueshme e shumë të nderuar. Ajo respektohet, ashtu siç edhe këndon në një këngë të saj "Si një zonjë e randë" sepse në asnjë moment nuk është shkëputur nga dashuria dhe respekti që ka për qytetin e Shkodrës dhe anasjelltas. Në ekranet e televizioneve dhe emetimet e valëve të radios, shpesh bie heshtje në ambientet familjare ose lokalet e qytetit për ta dëgjuar atë, por edhe më shpesh krijohen atmosfera të gëzueshme, sepse çdo i pranishëm do ta shoqërojë me zërin e tij këngën e saj.

Edhe unë kam pasur fatin e madh të bashkëpunoj me këtë këngëtare të madhe, ku mund të veçoj duetin e mrekullueshëm të saj me këngëtarën e shqar kosovare Shkurte Fejza në interpretimin e këngës "Të kam motër sa t'jem gjallë" me tekstin tim, muzikë të maestro Sabah Bytyçit, orkestruar nga mjeshtri Ilir Zoga.

Pas një karriere kaq të gjatë artistike, pas një suksesi 50-vjeçar në skenat shqiptare, por edhe ato në gjithë hapësirën shqiptare dhe në Diasporë, puna e kësaj këngëtareje, u vlerësua me titullin e lartë "Mjeshtre e Madhe" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë z.Bujar Nishani, një titull ky që i shkon përshtat kontributit të saj, talentit si një pekt që këtë lule e mbanë gjithmonë të freskët, ashtu siç janë të gjitha lulet në bahçet shkodrane.

Përgatiti RAMAZAN ÇEKA

I kemi dy shembuj burrash të "fortë" dhe ne!

Nga Besi BEKTESHI

"Moda" e fundit e kësaj kohe, është një lloj afeksioni apo dashurie për njerëzit e fortë, burrat e fortë në majë të pushtetit! I fundit është rasti i Presidentit Trump në deri tani, kryeveprën e demokracisë, ose USA, e cila në ditën e inaugurimit të tij, doli më me shumicë në protestë për këtë burrë të fortë, se sa në inaugurimin e tij?! Por sigurisht që kjo kërkesë paraqitet dhe te "stabiliteti dhe nacional ekonomia dhe politika" që një brez i ditëve të sotme politikaneësh, ju beson pikërisht këtyre "burrave të fortë" të shtetit. Bie fjala "dashuria për modelin Putin dhe Erdogan" që na vjen dhe si respekt nga modeli i ri tashmë në "White House" - sikur po përhapet dhe në mendjet e pastaj më të vegjëlvë në Europë. Sigurisht që është dhe Lukashenko që nuk po dëgjohet dhe po ashtu dhe modeli hungarez i Kryeministrit Urban. Në fakt, etnonacionalizmi dhe burrat e fortë të shtetit, nuk janë model demokracie amerikane. "Burrat e fortë" në Amerikë, kanë qenë gjithmonë në parime demokracie dhe sigurisht asnjëherë sidomos mbas viteve 1933, nuk mund të "ulërinin" parullën "America First", sepse nuk do të donin kurrë të ngjanin me "burrat e fortë" të Europës së vjetër?! Kurse në Europë po - sigurisht te kjo mrekulli njerëzore kanë dalë "burrat më të fortë të botës"! Ka dalë Musolini dhe Hitleri, ka dalë Stalini dhe Franko, ka dalë Çausheku dhe Enveri, por dhe shumë të tjerë diku më pak të fortë dhe diku më shumë - të fortë?! Sot një pjesë e madhe e përkrahësve të modelit "burrë i fortë" në Amerikë, po tallëshin apo po sulmonin dhe Papa Françeskun, sepse kishte kujtuar vitin 1933 dhe sigurisht "burrin e fortë Adolf Hitler"?! Nga erdhi kjo dashuri e një pjese të Europës e cila fenomenin e "burrave të fortë" e ka modelin e dikurshëm të saj, dhe që deri kohët e fundit ky model nuk e kishte prekur Amerikën?! Por me ardhjen e Trump në USA - të mbledhur në Gjermani Marine Le Pen, Matteo Salvini, Geert Wilders, Frauke Petry ose liderët anti BE, modelet e nacionalizmit ekstrem nga Franca, Italia, Holanda, Austria dhe Gjermania po ulërinin bashkimin për të larguar Merkelin dhe të tjerë si ajo në Europë, për ti hapur rrugën shteteve nacionale, me ekonomi të tillë dhe me parime të tilla në Europë?! Kufij të ruajtur më mirë si kombëtare, emigrantët jashtë tyre, monedhat e vjetra kombëtare, largim të ekspansionit indokinez dhe kinez apo indian ekonomik, rrëzim të plotë të Bashkimit European, proteksion të plotë mbi prodhimin vendas etj., etj., të kësaj natyre - është dhe fillimi i tyre në pushtet nëqoftëse vijnë. Gëzimi për Presidentin Trump, sigurisht që është i madh dhe i plotë të një model i tillë. Tashmë kanë një aleat të fortë që i shikon gjërat si ato. Pra

praktikisht kishim të bënim me Holanda first, Franca First, Italia First, Gjermania First, Austria First e kështu me rradhë të gjithë - first! Pse erdhi kontinenti deri këtu? Pse ky populizëm ekstrem i djathtë, nacionalizëm etnik, patriotizëm uluritës, kjo urrejtje për të ndryshmen, kjo fobi drejt emigrantëve? Pas goditjes nga "Brexit" në referendum dhe fitores së Trump - tashmë nuk kemi të bëjmë me një lojë që mund të luhet lehtë dhe bukur! Sigurisht që është goditur tregu i punës, është shpërndarë ai, ekonomitë në saj të globalizmit kanë bërë shpejt hapa të mëdha ato që dikur ishin shumë pas. Emigracioni ka tronditur themelet e një qytetërimi deri dje të sigurtë në Europë, raporti i qetësisë publike dhe sigurisë është prishur, ekspansioni ekonomik bëhet krejt ndryshe dhe puna largohet

(mos e dhëntë zoti) USA - GB dhe Rusi bashkë! Sigurisht që edhe ne kemi modelet tona të "njerëzve të fortë"?! I pari është Ahmet Zogu ose feudali modern shqiptar i kthyer në Monark, dhe me shikim shumë të qartë shtetëror me drejtim perëndim?! Kishte dëshirat e tij sundimtare dhe sigurisht kishte kundërshtar për vdekje dhe e fundit që "shpiku" ishte Monarkia të cilën e orientoi nga perëndimi vërtetë, por që lidhja me Italinë në mënyrë tepër ngjitur në saj të shpërdorimit të fondeve dhe raportit të keq me to - e mori në qafë. Vendi u ble nga fashistët ekonomikisht! Ishte një gjysmë tirani, por që kuptohej se "ja dinte zakonin popullit të tij"?! Ishte një popull që besonte te "burri i fortë" dhe Zogu ishte i tillë. I kishin bërë 50 atentate për ta vrarë - e ai ju bëri paksa dhe të tjerëve, por ky ishte

shumë raste, njeriu nuk do të sakrifikojë gjatë për të marrë atë që do, por do rezultate të menjëhershme që e çojnë në konflikte nga të cilat nuk del dot më. Rastet e trafikut dhe të korrupsionit janë shembuj ideal. Të pasurohesh në pak kohë, dhe t'i humbasësh në një kohë tjetër, apo të humbasësh dhe veten përgjithmonë. Mirëpo, shumë njerëzve ju pëlqen të vihen në këtë provë, ju duket zbavitëse aventura, ndjekin dëshirat e tyre duke kërkuar rezultate të menjëhershme dhe përballen me stuhinë e sjelljeve të tyre për një kohë të gjatë, dhe humbin paqen e brendshme përgjithmonë. Prandaj, të jesh vetëm ai që do në këtë formë nuk është e suksesshme dhe nuk jep rezultate afatgjata që shërbejnë. Atëherë ekziston vetëm një formë që e bën njeriun të suksesshëm dhe të marrë atë që do, të bëjë vetëm atë që duhet (që në vetvete është forma e sakrificës së pranueshme nga të tjerë). Por kjo është e mundimshme dhe sjellja e njeriut lëviz midis asaj që do, dhe duhet, ku vendosja e balancave është personale, duke përcaktuar në fund se kush jemi. Të rrëmbyer nga dëshirat, apo nga dëshira të rrëmbyera. për frymë të popullsisë?! Me atë nuk e kruante askush në kufijtë tanë?! Enveri të vriste dhe asnjë shqiptar nuk kishte "by..ë" të vriste shqiptarin tjetër?! Nuk u kontestua asnjëherë fortësisht dhe me rebelim si Zogu, nuk kishte dhe nuk lejonte asnjë disident dhe kundërshtar si Zogu - por vendi ishte plotësisht nën regjim dhe kontroll të plotë. Ka idiotë që Enverin duan ta bëjnë internacionalist" dhe këtë e ka trumbetuar dhe medemek të djathtët me moralin neokomunist në vitin 1992?! Por Enveri ishte një "etnonacionalist" që kishte zgjedhur medemek "Diktaturën e Proletariatit" si ideologji?! Këto



nga aty ku dikur ka qenë një mrekulli pasurimi etj., etj. Shembulli është i qartë mbi votuesit kryesor dhe thelbësor të Trump, ku zonat e mbetura pa punë, të industrisë së humbur amerikane, ku njerëzit kanë humbur jo vetëm mirëqenien e dikurshme, por dhe urbanizimin dhe shkollimin e mirë - është tashmë i qartë. Ky elektorat është me shumicë dhe në Europën që sigurisht është shumë më e kulturuar, por që me sa duket, një pjesë kanë harruar se çfarë i kanë sjellë "burrat e fortë" të saj! E kam fjalën te 100 e ca milionët e vdekur në dy luftra botërore në territorin ku sot është BE! Por arsyeja e ardhjes së etnonacionalistëve (nga bojë kafe te e zeza si ngjyra) të tillë nuk mungon - ajo është në fakt aty dhe tashmë nuk duhet përrjashtuar si një motor që lëviz për keq qytetërimin. Për këtë lloj motorri sigurisht kanë faj establishmentet si liberale, socialiste dhe të djathtës europianiste, por tani faji është bërë, dhe masat për tu riparuar kërkojnë energji dhe bashkim të këtyre forcave për të mos lejuar hyrjen e kontinentit të vjetër në konflikt ekonomik dhe politik dhe përballjen nga një model kundra tyre të tipit

modeli shqiptar i shtetit? Kjo ishte politika e shoqërisë shqiptare retro injorante. Në fakt tregohet i fortë në disa elementë që ishin ligji që i interesonte dhe pak a shumë gjyqet e rendi me gjendarmë, që nuk arritën të kontrollonin dot territorin plotësisht. Këtë burrë të fortë e njohën shumica e shteteve dhe ky burri i fortë i mbajti për së paku 11 vite nën hyqëm - shqiptarët?! Burri tjetër i fortë ishte Enver Hoxha. Të dy këto burra ishin alamet burrash dhe mbi kokat e të tjerëve sidomos Enveri! Nëqoftëse Zogu ishte gjysmë tiran, Enveri që donte ti ngjante nga pushteti atij - ishte një diktator dhe po ashtu një gjysmë tiran?! Kishte ideologjinë që e përdorte fortësisht si diktaturë të proletariatit. Godiste fortë dhe tinëzish, por edhe përballë! Ishte "full pushtet" e kontrollonte territorin plotësisht në saj të izolimit. Jepte shkollim, ngrinte institucione dhe jepte punë gjithkujt duke mos ja paguar asnjëherë si duhet. Kishte vendin më të armatosur në Europë dhe pothuaj në botë tjerët për të zgjeruar hapsirat personale që i japin më shumë liri veprimi. Një sjellje e tillë e bën të ndëshkohet ndonjëherë dhe të paguajë për të. Në

çapaçulët që po dalin me në krye Le Penin dhe ato mbas saj - janë disa zhgarravina të këtyre burrave që përmenda më sipër?! Ne i kemi pasur burrat e fortë sipër nesh - e sigurisht nuk erdhën kot. Me sa duket i "merituam" dhe po binden pothuaj të gjithë për këtë gjë. Por se vjen një kohë dhe prishet kaq shumë Europa sa të sjellë të çmendur dhe karikatura të të fortëve të dikurshëm si Hitleri, Musolini dhe Stalini së bashku me Enverin; kjo së paku mua përpara pak vitesh nuk më kishte shkuar në mend! Ne mbas viteve '90-të vendosëm dhe vazhdojmë të vendosim karikatura të Enverit dhe Zogut. Kryesori është Doktorin dhe ky është sërish një faj i madh i një shoqërie të tillë akoma e pa qytetëruar si e jona. Jemi fajtorë të mëdhenj për këtë gjë. Por - se dhe në USA dhe në Europë vijnë të tillë - do të thotë se popujt nuk kanë ndryshime të mëdha në edukatën dhe qytetërimin e tyre. Jo që nga Amerika, dhe deri në këndin tonë të Ballkanit ku jetojmë sot. Sepse të gjithë diktatorët dhe gjysmë diktatorët përpara se të vijnë - i bëjnë një palë zgjedhje ku populli i voton!

NDUE FTONI, NJERIU QË PARAJA NUK IA "ERRËSON" SYTË

Shqurku, është festa e Shoshit dhe ku ka më bukur se, kur kjo festë, fale njerit prej bijve të kësaj zone dhe pikërisht Ndue Ftonit, të festohet në këto përmasa, ku miqtë ishin Ministri i Brendshëm, Dritan Demiraj, por edhe, artist të këngës dhe humorit, përfaqësues të mediave e mjaftë të tjerë

Në këtë mbrëmje feste të krahinës së tij, biznesmeni Shqiptaro – Amerikan Ndue Ftoni, duke treguar se është njeri ndër bijtë më të mirë të Dukagjinit dhe Shkodrës, duke treguar se paraja nuk ia ka errësuar sytë, çka rëndom ndodh tek disa të tjerë, por mbi të gjitha mund të vlerësohet fakti se zemra e tij e madhe e bardhe, paraja e fituar me djersë dhe sakrificë ia ka mundësuar, të tregojë në realitet shpirtëbardhësin e tij Ja tekta ka marre mikrofonin në dorë, Ndue Ftoni, tashmë mbase fale edhe të qenurit pronar e një media në Amerikë për Shqiptarët, pa përtese bën edhe detyrën e moderatorit të festës së Shën Shqurkut ... Më tej gjithë për të gjithë e në veçanti për njeriun e dashur të artistëve dhe gazetarëve, Ndue Ftoni ... Kënga e Bujar Qamilit, është mezja e kësaj mbrëmje, por edhe humori i Bes Çinarit, edhe kënga e të talentuara Elvira Fierza edhe ... Natyrisht kjo darkë festive mori tjetër përmase tekta në tryezë me të gjithë është edhe Ministri i Brendshëm, Dritan Demiraj, dhe po me të gjithë një foto, është një kujtim i bukur në këtë mbrëmje.

Përgatiti **Gezim Vuçaj**

NDUE FTONI, SA HERË NË SHKODËR VJEN

Sa herë që z. Ftoni vjen në Shqipëri, pra në Shkodër, ai para largimit shtron rregullisht tervesen bujare për t'u takuar me miq e shokë, si dhe personalitete të kulturës dhe artit, duke e kthyer këtë treveser në një festë thellësisht shqiptare me këngë, valle, folklor dhe humor, që tregojnë jo vetëm ndjenjat dhe dëshirat e këtij burri, por mbi të gjitha idenë e madhe të bashkimit vëllazëror. Në këtë trevese çojnë goten e tyre edhe personalitete të shquar, kontribues të kulturës shqiptare, por këtë herë për këtë mikpritës bujar, ilustrimi më i bukur dhe falenderimi më i ngrohtë që i bënë të pranishmit, ishte edhe pjesëmarrja e

Ministrit të Rendit z. Dritan Demiraj. Respekt të madh me shumë konsideratë për këtë burrë të suksesshëm me banim në Amerikë, i cili është një ndër biznesmenët më të fuqishëm në Michigan, por mbi

të gjitha me një stacion televiziv shqiptar, ku promovohen vlerat e kombit tonë, duke u bërë kështu një ambasador i vërtetë. shqiptaro-amerikan.

Përgatiti **Ramazan Çeka**



MIQ PËR FESTË TEK NDUE FTONI

Sot fjala ime e pare është "Me zemër të mirë festën Fisi i Shoshit!"

Mbrëme isha pjesë e një mbrëmje të veçantë, në ambientet e Bar - Resorant "BLINI".

Traditë, bujari, kulturë, art, muzike ...

Një familje Shoshjane festonte Shën Shqurkun në Shkodër. Një burrë Dukagjinas vinte familjarisht nga Amerika për të festuar me vëllezër, miq e kolege .

Shkodra hap sytë para krenarisë dhe traditës së maleve!

Guximi i Shqiptarit, Ora e gjallë e malësorit, ndihma e Zotit janë ato cilësi që e bëjnë z, Ndue Ftoni fenomen! Aty ishin mjaft figura elitare që festën e kthyen në spektakel.

Ministri emblemantik Dritan Demiraj; Mjeshtri Bujar Qamili; Grupi Treva dhe Elvira Fierza; Aktoret e humorit Gëzim Kruga, Besnik Çinari dhe grupi Gaz e Maraz.

Gazetari i njohur Ilir Buçpapaj nga TVSH. por edhe grupi i TV Kopliku e Blue Sky. Shumë miq e koleg, nuk lë dot pa përhendet zj Rajmonda Marku, z. Arben Mazi, z. Gjovalin Dushaj, z. Pjeter dhe Arben Matusha, Poeti Ramazan Çekaj, rap-sodi Mhill Çuni. dhe publicisti Ili Kurti; Miqtë e mi z Ndue Sanaj e Gëzim Vuçaj.



Le të thotë kush të dojë, se jemi në kohe modern, por tradita mbetet traditë.

Le të tundin diplomat, dhe të mburren me karrigen pseudointelektualet, por njerëzit me zemër të madhe bëjnë diferencën. Me zemër të mire festa Shoshiane! Respekt dhe mirenjohje, për ju z. Ndue Ftoni!

Përgatiti **Lulash Brigja**

REDAKSIA

Kryeredaktor: **Luigj Shyti**

Redaktorë: **Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja**

Mundësoi
Botimin:
NDUE FTONI

